


Studiuesi dhe kritiku i shquar Ali Aliu lindi më 1934 në Kranjë të Prespës. Shkollën tetëvjeçare e filloi në vendlindje dhe e kreu në Manastir më 1951, ndërsa Shkollën Normale në Shkup më 1955. Studimet universitare (albanologji) i mbaroi në Beograd në vitin 1960. Punoi si gazetar në “Flaka e vllaznimit” në Shkup. Prej vitit 1969 deri në vitin 1972 punoi redaktor në Edicionin e Botimeve “Rilindja” në Prishtinë. Që nga viti 1972 deri sa doli në pension ishte profesor në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt i saj. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Akademisë të Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë.

ALI ALIU: NDRYSHE NDIHEM MIRË NË SHKUP, NDRYSHE NË TIRANË, NDRYSHE NË PRISHTINË.

Intervistoi B. Hudhri

(fq. 2)



PIRAMIDALE

Nga Arb Elo

(fq. 8)

Pas njëzet e ca vjetësh prej botimit të parë, u bëra mbarë të lexoj “Piramida” e I. Kadesë, për një sërë arsyeshe: nuk kam qenë aty kur është publikuar te “Rilindja Demokratike”; kur jam gjendur në Tiranë ose më ka dalë nga mendja, ose edhe nuk e kam gjetur kur e paskam kërkuar. Mirëpo shpejt u ndjeva me fat që nuk e paskam lexuar asokohe; nuk do të kisha patur qetësinë e duhur atëbotë për ta lexuar këtë libër siç duhet, siç edhe vetë autori, cilido autor, ma do mendja, pret të lexohet...



CARMINE ABATE DHE MODERNITETI I PROZËS SË TIJ

Prof. Dr. Bardhosh Gaçe

(fq. 6)

CARMINE ABATE njëri nga pjesëtarët e plejadës së shkrimtarëve bashkëkohorë të letërsisë arbëreshe, por që nuk ngjan me asnjërin. Ai është një personalitet i dijes dhe kulturës arbëreshe dhe asaj italiane, i cili ka një vend të sigurt dhe të dukshëm në mozaikun tematik, shkencor, kulturologjik dhe të letërsisë bashkëkohore arbëreshe...

SI U DHA ÇMIMI I PARË NOBEL PËR LETËRSINË

Pas shumë hezitimesh, diskutimesh, zvarritjesh dhe pikëpyetjesh edhe pa përgjigje, Akademia suedeze, i jep më 1901 dhe për herë të parë Çmimin Nobel të Letërsisë, Sully Prudhomme, René-François Prudhomme, anëtar i Akademisë franceze. Vendimi u bë publik në Stokholm, më 10 dhjetor 1901.

(fq. 14)

Për kuptimin e jetës, pasi ia hoqën dënimin me vdekje DOSTOJEVSKI: SOT ISHA TE PORTA E VDEKJES

Në moshën njëzet e shtatë vjeçare, u arrestua ngaqë ishte pjesë e një shoqërie letrare që qarkullonte libra që ishin përcaktuar të rrezikshëm nga regjimi carist. U dënua me vdekje.

(fq. 17)

KUR JAMES JOYCE DHE MARCEL PROUST U TAKUAN NË VITIN 1922 DHE U MËRZITËN TMERRËSISHT NGA NJERI TJETRI

(fq. 16)



BIBLIOTEKË

Rexhep Ferri

Veç me u çmend!...

(fq. 10)

Liridon Mulaj

Linda

(fq. 13)

Ardita Jatru

Kënga e fundit

(fq. 12)

Dashamir Malo

Dritëhija

(fq. 11)

Charles Baudelaire

Brenga e Parisit

(fq. 18)

VJESHTA E PËRJETSHME E DHORI QIRIAZIT

Yzedin Hima

(fq. 5)

Studiuesi dhe kritiku i shquar Ali Aliu lindi më 1934 në Kranjë të Prespës. Shkollën tetëvjeçare e filloi në vendlindje dhe e kreu në Manastir më 1951, ndërsa Shkollën Normale në Shkup më 1955. Studimet universitare (albanologji) i mbaroi në Beograd në vitin 1960. Punoi si gazetar në “Flaka e vllaznimit” në Shkup. Prej vitit 1969 deri në vitin 1972 punoi redaktor në Edicionin e Botimeve “Rilindja” në Prishtinë. Që nga viti 1972 deri sa doli në pension ishte profesor në Fakultetin Filozofik në Prishtinë. Në vitin 1996 u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, ndërsa në vitin 2000 anëtar i rregullt i saj. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i Akademisë të Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë.

ALI ALIU: NDRYSHE NDIHEM MIRË NË SHKUP, NDRYSHE NË TIRANË, NDRYSHE NË PRISHTINË.

Intervistoi B. Hudhri

I nderuar profesor, kujtimet e fëmijërisë nga Kranja, fshati juaj i lindjes buzë liqenit të Prespës, kanë diçka të paharrueshme për ju: hapjen e shkollës së parë shqipe dhe ju si nxënës i klasës së parë.

Kujtimet që kanë lënë gjurmën më të gjallë lidhen me ditën kur Prespa, pra edhe Kranja, u bënë Shqipëri, që i thoshin koha e pushtimit të Italisë. Isha pesë-gjashtë vjeç atëherë, por mbaj mend shumë gjëra edhe para kësaj moshe, që kanë lidhje pikërisht me këtë ditë. Një nga këto kujtime është edhe ky: sa herë që vinin mysafirë në shtëpinë tonë dhe në odën e madhe shtrohej sinia rrumbullake e muhabetit, në krye të së cilës zinte vend gjyshja Meleke, për ta ngritur e para kupën e rakisë, urimin e mirëseardhjes gjithnjë e përfundonte me fjalët: “U bëfshim Shqipëri!” Gjyshja, që asokohe thoshin se kishte mbushur 90 vjeç, ishte nga fshati Nikolicë i Shqipërisë që, sa herë e zinte ngoje, thoshte: “Mos vdeksha pa shkuar edhe një herë!” Po kthehem te dita kur u bëmë Shqipëri...

Në pritje të karabinierëve italianë në rrugë ishte e tërë Kranja, gra e burra, pleq e fëmijë, duke i shoqëruar udhëve me daulle e gërneta, diku edhe me lule. Ishte pranverë e hershme dhe Kranja ka shumë ujëra nga burimet e Pelisterit, prandaj vijat anash ishin përplot me ujë, që vende-vende i mbulonin edhe udhët. Ne fëmijët vraponim kush mbathur dhe kush zbathur për t’i ndjekur nga pas mysafirët me uniforma, por edhe disa pa uniforma, burra të ardhur nga Shqipëria bashkë me ta. Më kujtohen copëza fjalësh e fjalish nga ajo që thoshin mysafirët dhe që përcillej në turmë, si për shembull: “Të mos ishte gjoli, para se të vinim ne, në Kranjë do të vinte bullgari.” Pra, ata i paskëshin rënë trup liqenit pa shkuar rrotull dhe kishin mbërritur ta vënë kufirin me Bullgarinë përpara Kranjës. Ndërsa para këtij kujtimi, natyrisht më të zbehtë, gati si nëpër një ëndërr, më kujtohet dita e nevruzit, kështu i thoshte gjyshja Meleke, kështu i thoshim edhe ne. Gjyshja ishte myhype, që kishte marrë dorë në teqenë bektashiane, në atë të Baba Saliut në Manastir. Dhjetë ditë para festës së nevruzit, vetëm gjyshja në shtëpinë tonë nuk pinte ujë. Unë flija me të, se nëna më kishte lënë gjashtëmuajsh. Gjatë ditëve të matemit, babai merrte një libër që e quante *Qerbela*, i cili rinte gjithnjë mbi kurrizin e një sahati të madh të varur në mur që binte si kambanë, dhe na ulte të gjithëve në rreth për të na lexuar luftën e imam Aliut kundër Jezitit, Mavijes. Gjyshja zakonisht qante.

Në Kranjë u hap shkolla shqipe. U mbush oborri i një ndërtese njëkatëshe, që kishte qenë shkollë në gjuhën serbe. Për herë të parë shihja aq shumë fëmijë në Kranjë,

që asokohe kishte afro katërqind shtëpi thoshin dhe që unë shumicën nuk i kisha parë asnjëherë. U lidh Kranja atëherë me Korçën, meqë Prespa ishte nënprefekturë e Korçës, prej nga erdhën katër mësues nga Shqipëria. Nëpër klasa na ndanë sipas moshës dhe sipas nxënësve, që deri atëherë shkonin në shkollën serbe. Në klasën e parë, ku më regjistruan edhe mua, kishim një mësuese me emrin Dhorka Qeleshi, korçare.

Maja e Pelisterit e ndan vendlindjen tuaj nga Manastiri, një qendër e rëndësishme e kulturës dhe patriotizmit shqiptar. Ju vazhduat arsimin fillor atje dhe siç thoni diku, konvikti ku keni ndenjur ishte ngrehina ku u mbajt kongresi i famshëm i alfabetit shqip. Po atëherë nuk është se e dinit, apo jo? Duket sikur jeni mëkuar që në moshë fare të re me dashurinë për gjuhën shqipe.

Gjatë atij qëndrimi katërvjeçar, kur futeshim në mëhallën e shqiptarëve, në periferinë perëndimore të qytetit, ose kur na ftonte ndonjë nga shokët vendas të klasës në shtëpi, mbaj mend që flitej si nëpër ëndërr për një si fabrikë të vogël të familjes Qirjazi që nxirrte libra: ja aty pranë e kishin shtëpinë, por s’mbeti njeri. Flitej gjithashtu se në një shtëpi dykatëshe me ngjyrë të verdhë, ngjitur me spitalin, ka mësuar shkrimtari me emrin Migjen. Flitej copa-copa se në stadiumin e futbollit, ku shkoja shpesh të dielave, një sulltan i Turqisë paskësh thirrur krerët shqiptarë në një gosti të madhe dhe i paskësh vrarë të gjithë, pa lënë asnjë të dalë i gjallë.

“...se në një shtëpi dykatëshe me ngjyrë të verdhë, ngjitur me spitalin, ka mësuar shkrimtari me emrin Migjen. Flitej copa-copa se në stadiumin e futbollit, ku shkoja shpesh të dielave, një sulltan i Turqisë paskësh thirrur krerët shqiptarë në një gosti të madhe dhe i paskësh vrarë të gjithë, pa lënë asnjë të dalë i gjallë.

Në vijim të jetës shkollore përpara jush shfaqet një qytet kryesisht me shqiptarë: Tetova. Tani ishit më i rritur, por çfarë kishit kuptuar ndërkohë, cila do të ishte e ardhmja juaj, cilat ishin ëndrrat?

Në fillim të viteve pesëdhjetë, dy vitet e para të Normales i bëra në Tetovë. Në këtë qytet, që gjatë periudhës italiane kishte qenë qendër prefekturë dhe ku gjatë atyre viteve ishte ngritur një bibliotekë e pasur, për herë të parë pashë libra shqip. Në konviktin e Manastirit gjatë katër viteve mbaj mend që të kisha lexuar ndonjë libër në maqedonishte, pa m’u kujtuar mirë titulli i librit apo autori. Gjatë luftës dhe pas ikjes së Italisë, siç thoshin banorët e Tetovës, librat e bibliotekës kishin përfunduar në biblioteka private. Njëra nga vajzat e klasës sonë, tetovare me mbiemrin Malaziu (nuk më kujtohet emri), filloi të më sjellë herë pas here libra nga shtëpia, pa ndonjë rend, çfarë i binte në dorë. Atje për herë të parë e kam prekur me dorë dhe e kam lexuar romanin e Dostojevskit “Krim dhe dënim”, më duket në përkthim të Tajar Zavalanit. Kështu fillova të lexoj libra, çfarë më binte në dorë. Pas dy viteve të qëndrimit në Tetovë Shkolla Normale, e vetmja shkollë e mesme shqipe në Maqedoni, u zhvendos nga Tetova në Shkup. Në kryeqytet ishim më komod me hapësirë, një ndërtesë e madhe me oborr, ku ishte vendosur edhe shkolla edhe konvikti, në qendër të qytetit, por nuk u familjarizua asnjëherë me qytetin, siç ndiheshim në Tetovë, ku qyteti na dukej si shtëpia jonë.

Keni qenë student në Shkup së pari, pastaj keni vazhduar në Beograd. Në vitet ’50 Beogradi, si kryeqytet i Jugosllavisë, ishte një qendër e rëndësishme universitare, politike dhe ekonomike. Mund të na flisni për çfarë studiuat? A kishte shumë studentë shqiptarë? Zgjedhja e degës ishte në dorën tuaj apo ishte paracaktuar që më parë?

Nga gjysma e viteve pesëdhjetë të shekullit të kaluar e deri në fillim të dhjetëvjetëshit gjashtëdhjetë vazhdova në Beograd, si banor i qytetit të studentëve, një mjedis me rreth pesëdhjetë mijë banorë-studentë nga mbarë Jugosllavia e atëhershme. Në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe pranë Fakultetit Filozofik të Beogradit, në gjuhën shqipe na ligjëronin profesor Idriz Ajeti dhe profesor Vojislav Dancetovic për gjuhën shqipe, ndërsa profesor Anton Çetta për letërsinë shqipe. Të gjitha lëndët e tjera i dëgjonim në gjuhën serbe, ku lënda bosht dhe kryesorja ishte letërsia jugosllave, që dëgjohej gjashtë semestra me më shumë profesorë, dhe teoria e letërsisë me katër semestra. Katedra jonë për çdo vit kishte rreth dhjetë-pesëmbëdhjetë studentë. Kishte një bibliotekë modeste të librit shqip, kryesisht të Rilindjes. Me autorë dhe libra nga letërsia jugosllave – në program të saj ishin letërsitë e gjashtë republikave dhe ndonjë autor nga dy krahinat, – biblioteka ishte e furnizuar me bollëk. Sa më kujtohet, bibliotekës në katedrën tonë asokohe i vinte revista “Nëntori” nga Tirana, në faqet e së cilës mbaj mend të kem lexuar prozë nga Shuteriqi, Ali Abdihoxxha, Kim Dushi, Musaraji.

Gjatë viteve të kaluara në Beograd kohën më të madhe e kaloja në lexim të librave, sidomos klasikët e shekullit nëntëmbëdhjetë. Frekuentoja rregullisht tribunën e njohur Kolarc, në kuadër të Universitetit të Beogradit. Aty kisha rast të përcjell takime dhe biseda, pos me shkrimtarë të njohur jugosllavë, edhe me emra të shquar ndërkombëtarë. Isha gjithashtu vizitor i parapaguar, me biletë vjetore për studentët, në teatrin jugosllav të dramës, në skenën e të cilit në ato vite, duke qenë ende student, filloi të shfaqet aktori shqiptar Bekim Fehmiu.

Kur u kthyet në Shkup, filluat punë në gazetën “Flaka e vëllazërimit”. Jam kureshtar të di, shkrimet tuaja të para si gazetar nisin këtu? Ishte një kohë jo aq e përshtatshme për gazetari objektive, aty ku jetonit dhe vepronit ju. Si i përballonit sfidat e natyrës politike? Mos patët ndonjë pasojë? Besoj se aty ka filluar edhe interesimi për kritikën letrare. Si ndodhi që iu përkushtuat kësaj?

Pas studimeve u ktheva në Shkup dhe u punësova gazetar në redaksinë e gazetës së përjavshme “Flaka e vëllazërimit”, vend në të cilin gati e mbylla decenien e viteve gjashtëdhjetë. Në këtë të përjavshme të vetme në



gjuhën shqipe në Maqedoni mbaja dy faqe gazete për kulturë dhe arsim. Nga kultura përmbledhja ngjarjet në fushën e letërsisë dhe teatrit. Në Shkup gjatë atyre viteve kishte vetëm një teatër shqiptaro-turk, ku një ndërtesë dhe një skenë e ndanin dy pakicat, si emërtoheshin shqiptarët dhe turqit asokohe. Nga fundi i viteve gjashtëdhjetë doli edhe revista e parë letrare në gjuhën shqipe, “Jehona”. Shumë në të rrallë botohej edhe ndonjë libër shqip, e më shpesh libra të përkthyer nga autorë jugosllavë. Në Shkup, por edhe në qytetet e tjera të Maqedonisë, qysh në atë kohë kishte ngjarje dhe manifestime letrare, si *Mbrëmjet poetike strugane* e shumë të tjera, të cilat redaksia jonë kishte obligim t’i përcillte. Fillova kështu ta njoh botën kulturore, sidomos letërsinë maqedonase. Jashtë obligimit të kësaj natyre vazhdimisht një sy e mbaja drejt Prishtinës, ku në institucionet arsimore dhe kulturore e publicistike ishin përfshirë shumica e kolegëve të mi nga koha e studimeve në Beograd. Prandaj fillova të botoj herë pas here në faqet e gazetës “Rilindja” në Prishtinë, sidomos shkrime për teatrin, letërsinë, por edhe për manifestimet letrare të Shkupit

Natyrisht, ajo që më së shumti më pëlqente dhe që më shumë më tërhiqte gjatë viteve të mia të gazetarisë në Shkup ishte letërsia. Duke informuar për manifestime letrare, për libra të promovuar dhe të vlerësuar me çmime vjetore, duke bërë informimin fillestar për përmbajtjen e tyre, me kohë fillova që këtë aktivitet ta përcjell edhe me ndonjë koment, me pretendime vlerësuese, që u bë më vonë fusha në të cilën u përqendrova.

vazhdimisht një sy e mbaja drejt Prishtinës, ku në institucionet arsimore dhe kulturore e publicistike ishin përfshirë shumica e kolegëve të mi nga koha e studimeve në Beograd. Prandaj fillova të botoj herë pas here në faqet e gazetës “Rilindja” në Prishtinë, sidomos shkrime për teatrin, letërsinë, por edhe për manifestimet letrare të Shkupit.

Në fund të viteve ’60 ju ftojnë në Universitetin e Prishtinës. Atje gjetët miqtë dhe shokët tuaj me të cilët kishit studiuar bashkë. “Rilindja” dhe Universiteti i Prishtinës u bënë dy qendra të rëndësishme kulturore. Na thoni diçka më konkretisht për këtë kohë e për këtë atmosferë?

Në fillim të viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar u vendosa në Prishtinë. Fillimisht, dy vitet e para, në shtëpinë botuese “Rilindja”, bashkë me Ramiz Kelmendin, Rrahman Dedajn, Fahredin Gungën, Nazmi Rrahmanin, të cilët, së bashku me shkrimtarë të tjerë, si Azem Shkreli, Anton Pashku, Ali Podrima etj., kishin botuar librat e parë dhe kishin bërë emër. Redaksia e botimeve “Rilindja”, që asokohe ishte ngritur në një shtëpi të shqiptarëve nga mbarë Jugosllavia, brenda këtij aktiviteti, në gjirin e vet kishte themeluar edhe një bashkëpunim, sado të kufizuar, me redaksinë e botimeve “Naim Frashëri” të Tiranës. Pos një numri botimesh të gatshme që shkëmbenim, ata na dërgonin edhe vepra në dorëshkrim, ende të pabotuara atje, që ne të mënjanonim çfarë nuk shkonte dhe çfarë nuk mund ta bluante mulliri i këtushëm dhe t’i botonim. Po në këtë periudhë për herë të parë “Rilindja” filloi të botojë romane në dorëshkrim, siç ishte edhe “Kështjella” e Ismail Kadaresë, që e kam lexuar në dorëshkrim. Në këtë hark kohor bashkëpunimi filloi edhe seria e veprave komplete, gjithnjë për herë të parë në hapësirën shqiptare, opusi letrar i Petro Markos, proza e Ali Abdihoxhës, kompleti i romaneve të Jakov Xoxës; më pas, nga gjysma e dytë e viteve shtatëdhjetë, për herë të parë do t’i botohet kompleti i veprave edhe Dritëro Agollit, Ismail Kadaresë, Eqrem Çabejit etj. Është për t’u theksuar se të gjitha këto vepra e autorë që i përmenda, dhe botime të tjera, në tregun e Kosovës gati shiteshin brenda ditës. Ekzistonte një entuziazëm i madh tek të rinjtë, ndër studentët e Universitetit të Prishtinës sidomos. U gëzoheshin botimeve letrare, organizoheshin takime të shpeshta të shkrimtarëve në Kosovë dhe jashtë Kosovës me lexues, më rrallë edhe me shkrimtarë nga Shqipëria. Në Prishtinë, pas brezit të Esat Mekulit, Hivzi Sulejmanit, Tajar Hatipit, Zekeria Rexhës, që ishin bërë gati klasikë, ishin afirmuar edhe emra, si Enver Gjerqeku, Ramiz Kelmendi, Rexhep Hoxha etj., dhe pas tyre brezi i autorëve të përmendur më sipër, si Azem Shkreli, Rrahman Dedaj, Ali Podrimja, Nazmi Rrahmani, Fahredin Gunga, Din Mehmeti, Besim Bokshi, po shfaqeshin edhe më të rinjtë, si: Sabri Hamiti, Zejnulla Rrahmani, Eqrem

Basha, Mehmet Kraja, Teki Dërvishi, Beqir Musliu, Musa Ramadani etj.

Mund të thuhet se vitet shtatëdhjetë janë vitet e një zhvillimi shpërthyes në të gjitha fushat në Kosovë. Ajo, edhe pse nuk e kishte siglën e republikës brenda ish-Jugosllavisë, i kishte pothuajse tërë nishanet e saj. Ishte dhjetëvjetëshi kur përjetoj një hov të paparë arsimor, kulturor dhe shkencor, përfshirë nga një entuziazëm shpërthyes, nga një zgjim i brendshëm që mëtonte të zërë ritmin e humbur në kohë. Prishtina u bë qendër arsimore e kulturore për mbarë shqiptarët në Jugosllavi. Universiteti i saj po rangohej pa u skuqur brenda dymbëdhjetë të tillëve në hapësirën e atëhershme jugosllave. Rektorë të rangut si Gazmend Zajmi me shokë, edhe kur e kishin radhën sipas rotacionit të atëhershëm të udhëheqin bashkimin e universiteteve jugosllave, ndiheshin të barabartë, por shpesh edhe superiorë. Njësoj, sipas të njëjtit rotacion, edhe në Lidhjen e Shkrimtarëve të Jugosllavisë, kur ajo udhëhiqej nga poeti Azem Shkreli, që si krijues dhe intelektual qëndronte midis majave, shkëlqente gjithashtu. Në këtë kontakt dhe hapësirë kohore ndodhi edhe bashkëpunimi arsimor dhe kulturor mes Prishtinës dhe Tiranës. Në fakt, ishin dy porta të hapura: mes dy universiteteve dhe dy shoqatave të shkrimtarëve, asaj të Kosovës dhe të Shqipërisë. Nën këtë ombrellë bashkëpunimi u përfshi një numër i madh profesorësh nga Universiteti i Tiranës, me leksione gati të rregullta, sidomos në fakultetet me mungesë kuadrosh nga fusha e shkencave ekzakte dhe mjekësore, por edhe në albanologji. Kishte shkëmbim institucionesh, shkëmbim shfaqjesh teatrore, ansamblesh dhe koncertesh muzikore, shoqatash folklorike etj.

Ju po më pyesni pse nuk mund t’i heqim barrierat e bashkëpunimit të paktën në këto fusha sot. Është pyetje para së cilës njeriu i ngre supet. Të shkon mendja nganjëherë të thuash mbase pse na rri mbi kokë një shpatë që kërcënon dhe ta ndërpret çdo bashkëpunim të mundshëm, sa herë të dojë dhe sa herë t’i teket. Mbase mos jemi natyrë që, kur na lihet vetvetja në dorën tonë, jemi shpërdorues të lirisë, të vetvetes. Ju po thoni që një bashkëpunim i tillë i mungon edhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Kjo qëndron pjesërisht. Në mes dy akademive për çdo vit nënshkruhet një protokoll bashkëpunimi i dyanshëm dhe gjatë çdo viti mbahen dy deri në tri konferenca, tryeza të përbashkëta. Ekzistojnë gjithashtu marrëdhënie të mira ndërpersonale pune. Mungojnë projektet afatgjata që nuk mund të ndodhin pa përkrahjen e nevojshme nga shoqëria, kur është fjala për këto nivele bashkëpunimi.

“Në këtë kontakt dhe hapësirë kohore ndodhi edhe bashkëpunimi arsimor dhe kulturor mes Prishtinës dhe Tiranës. Në fakt, ishin dy porta të hapura: mes dy universiteteve dhe dy shoqatave të shkrimtarëve, asaj të Kosovës dhe të Shqipërisë. Nën këtë ombrellë bashkëpunimi u përfshi një numër i madh profesorësh nga Universiteti i Tiranës, me leksione gati të rregullta, sidomos në fakultetet me mungesë kuadrosh nga fusha e shkencave ekzakte dhe mjekësore, por edhe në albanologji. Kishte shkëmbim institucionesh, shkëmbim shfaqjesh teatrore, ansamblesh dhe koncertesh muzikore, shoqatash folklorike etj.

Kur keni shkelur për herë të parë në Shqipëri?

NëkuadërtëbashkëpunimitmesLidhjessëShkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë dhe Shoqatës të Shkrimtarëve të Kosovës, në pranverën e vitit 1970, kjo e fundit mori një ftesë nga Lidhja për të marrë pjesë në shënimin e shtatëdhjetëvjetorit të vdekjes së Naim Frashërit. U caktua një grup, më duket prej 10 ose 12 anëtarëve, – Esad Mekuli, Mark Krasniqi, Vehap Shita, Azem Shkreli, Rexhep Qosja, Rahman Dedaj, Ali Podrimja, Nazmi Rrahmani, në mesin e të cilëve edhe unë. Ishte ngjarje e rëndësishme, sidomos për ne që do të vinim për herë të parë në Shqipëri, prandaj besoj, si të tjerët, atyre ditëve, para nisjes, isha i përfshirë nga emocionet e pritshmërisë.

Në Shqipëri hymë nga Hani i Hotit, ku na prisnin përfaqësues të Lidhjes. U nisëm drejt Tiranës në kolonë së cilës i printe njëra nga makinat e mikpritësve që e ndiqja unë me Fiatin tim 1300, duke pritur me padurim të mbërrijmë sa më shpejt në kryeqytetin e Shqipërisë. Diku, mbase afër Tiranës, ku m'u duk rruga si më e përshtatshme për të rritur shpejtësinë, – më bëhet se e kisha Podrimjen dhe Shkrelin në makinë, – e shkela gazin, dhashë shenjë dhe dola në krye të kolonës. Nuk zgjati shumë temp i ri i kolonës, shoferi mikpritës të cilin e kalova më dha shenjë, dha sinjalin e krahut të majtë, rriti shpejtësinë dhe doli përsëri në krye – solli rregull me shpejtësinë 50-60 km në orë, shenja e parë, elegante, e disiplinimit. Në Tiranë, para se të vendosemi në hotel, zbarkuam drejt e në oborrin e Lidhjes. Shkallëve drejt hyrjes së një godine të bukur na priste, në krahun e djathtë dera krahëhapur drejt sallës së madhe, një grup shkrimtarësh, mbase pesëmbëdhjetë a më shumë, të gjithë në këmbë. Besoj se nuk njihnim asnjërin – të paktën unë – dhe besoj se nuk njihnin as ata ndonjërin nga ne, pos ndonjërin që mund ta kishim parë, përkatësisht mund ta kishin parë ata në foto a diku. Mbj mend që u përziemë brenda në një atmosferë dhe ambient surreal, në një si kërkim të njëri-tjetrit, si mes të njohurve moti e të mosnjohurve kurrë. Në atë gjendje gjysmëpërgjumjeje afrohet drejt meje një mesoburrë, me një qeshje të hapur mirësie, përhapëse, tërheqëse, me flokë të zinj të bujshëm dhe më mori në përqaftim: jam Dhimitër Xhuvani, ma shqiptoi emrin në vesh, duke më mbajtur gjatë ashtu. Po, më kishte parë në televizionin e Beogradit. Asokohe

Prishtina ende nuk kishte televizionin e vet. Kishte një dritare, më duket disaorëshe në javë, dhe brenda tyre edhe nja 15 minuta kulturë, brenda të cilave unë kisha folur për romanin e tij “Përsëri në këmbë”. Dikur dikush na ftoi – mbase Dhimitër Shuteriqi – të zinim vend rreth një tavoline të madhe, të rrumbullakët, ku ishin servirur gotat e rakisë dhe mezet. Nuk më kujtohet nëse vendet ishin të caktuara përpara për secilin apo jo, por mbaj mend se u gjenda në një karrige me shikim nga muri-xham që shikonte nga oborri, mes një zonje në të majtë, që ishte nga administrata e Lidhjes, dhe në krahun e djathtë me Ismail Kadarenë, të cilin e kisha parë diku në foto. Nuk mbaj mend shumë detaje as nga ky takim, pranë gotave që, tok me gëzimin nga ftesat e Lidhjes, ditët e përgatitjes, udhëtimin... kishin krijuar ritëm real dhe virtual bashkë, por një detaj, nga ndeja në krah të Kadaresë, kureshtar, por edhe i hutuar, më ka mbetur i gjallë. Brenda një zhurmërimi, pas kupës së Kryetarit të Lidhjes për mirëseardhje, që u krijua mes bisedash tani tek-e-tek, po prisja një reagim kontakti me Kadarenë. Nuk ecnin as minutat në heshtje. Ktheja kokën herë-herë me kujdes në atë drejtim dhe mbaj mend sikur Kadareja e kishte fiksuar shikimin diku në një qoshe të tavanit të lartë dhe dukej sikur nuk ishte fare i pranishëm. Heshtja dhe prisja nuk e di sa kohë, kur m'u drejtua me një pyetje: “Ju jeni redaktor i disa botimeve te *Rilindja* e Prishtinës, nga autorë të Shqipërisë?” “Po”, - i them, meqë si redaktor në shtëpinë botuese “Rilindja”, ku isha bashkë me Ramiz Kelmendin dhe Nazmi Rrahmanin, kisha firmën në romanet e P. Markos, A. Abdihoxhës, J. Xoxës, e vazhdimin e mëtejme të bisedës së nxitur nga kjo pyetje e pasoi pyetja tjetër: “Dhe nuk gjete asgjë më të mirë për botim?” Gati u preva, si t'ia shpjegoja se autorë nga Shqipëria botonim ç'na binte në dorë, rastësisht, mjaftonte të ishte pa problem nga syri i censurës jugosllave. Vetëm të ishte autor nga Shqipëria dhe lexuesi i etshëm e rrëmbente si dhuratë të Zotit. Kështu mbeta pa fjalë. Ishte i papërballueshëm argumenti – besimi absolut i Kadaresë për formatin e shkrimtarit.

Më 2005, shtëpia botuese “Serembe” në Shkup jua botoi kompletin e veprave në katër vëllime, deri atëherë ju ua botonit të tjerëve veprat në komplete. Si e pritët këtë ndërmarrje?

Po, në vitin 2005 shtëpia botuese “Serembe” në “Vepra të zgjedhura” botoi katër vëllime nga krijimtaria ime letraro-shkencore. Falë themeluesit dhe udhëheqësit të kësaj shtëpie botuese, shkrimtarit Resul Shabani, në Shkup për herë të parë u përkrah një projekt i tillë nga Ministria e Kulturës edhe për një krijues nga radhët e shqiptarëve. Dua të përmend se ishte fatkeqësi dhe dëm për jetën letrare në gjuhën shqipe në Maqedoni që shtëpia botuese “Serembe”, në mungesë të përkrahjes nga pushteti i atëhershëm, nuk arriti të mbijetojë, që do të thotë se aktiviteti botues shqiptar në Maqedoni dhe jeta letrare shqiptare nuk e shfrytëzoi përvojën e Resul Shabanit në këtë fushë, nuk e shfrytëzoi profilin e tij si njohësi më i mirë i të dy letërsive në Maqedoni, asaj shqiptare në përgjithësi dhe asaj maqedonase, për komunikimin e të cilave është një nga kontribuesit më të shquar.

A nuk duket sikur është zbehur roli i kritikut që me rënien e regjimit të kaluar? Më saktë: duket sikur mungon dukshëm, siç thuhet. Dihet roli që kishte kritiku atëkohë, por edhe mbështetja e madhe që kishte nga lart, për arsye të qarta ideologjike. Mos duhet ta gjejmë këtu arsyen pse nuk kemi një koncept të qartë të kritikut në kohën e sotme? Në Tiranë dhe Prishtinë janë një numër studiuesish dhe kritikësh të rinj që kanë studiuar në Perëndim. A janë ata shpresa për një zhvillim të pritshëm të kritikës?

Duke u pajtuar me konstatimin tuaj, përgjigjen po e nis nga fjalja e fundit e pyetjes: po, hapësira shqiptare e Ballkanit për çdo vit përcjell qindra të rinj për shkollim nëpër botë. Një numër i mirë i tyre kthehen. Natyrisht, jo të gjithë me diploma të universiteteve prestigjioze. Të tillët, edhe pse janë pakicë, për fatin tonë të keq, nuk pranohen nga kjo perspektivë përparësie, por trajtohen në turmë, bashkë me ata që kthehen me përgatitje modeste. Në mesin e pakicës ka të rinj me formim të lartë profesional që do ta

gjallëronin kritikën letrare, do ta rrisnin nivelin shkencor, por u mungon hapësira që do t'i stimulonte. Media jonë e marrosur pas reklamës dhe klikimit pëlqyes mekanik ka përjashtuar, në limite minimale, vlerat në art, në estetikë, në etikë... Këta të rinj, me përgatitje të lartë dijeje dhe formim nga këto fusha, edhe me pasionin për t'iu përkushtuar shkencës letrare, qoftë në Tiranë, qoftë në Prishtinë, dalin në rol të dytë përballë shoumenëve që, përditë e më agresivisht, e pushtojnë hapësirën mediatike, sidomos në fushën e vlerave për të cilën flasim, duke mos mundur të sigurojnë as minimumin e ekzistencës së përditshme sociale. Që do të thotë se për një ndryshim serioz në këtë fushë duhet ndërhyrje e përkrahje institucionale tash për tash e munguar.

Duke ju parë që ende drejtoni makinën dhe lëvizni shumë, jo vetëm në kryeqytetet tona, por kudo në ato vende ku flitet për librin, si në konferenca, panaire, promovime, dëshiroj t'ju bëj një pyetje të fundit: ku ndiheni më mirë?

Nuk kam menduar, përkatësisht asnjëherë nuk e kam pyetur veten nga kjo perspektivë. Natyrisht në Prishtinë, ku kam kaluar dhe po kaloj pjesën më të madhe të jetës, ku kam kolegë e miq të shumtë të punës, ku përditë e më shumë më njohin si gjyshi i Kreshnikut apo i Valit dhe ku shpresoj të përjetoj edhe lumturinë e të bërit stërgjysh. Por i gjendur përballë pyetjes suaj kapa një dallim që s'e paskështa hetuar: ndryshe ndihem mirë në Shkup, ndryshe në Tiranë, ndryshe në Prishtinë. Në këtë të fundit, për ato që thashë më sipër dhe për ato rreth tyre. Në Shkup, ku kam bërë shkollën e mesme dhe vitet e para të punësimit, shkoj me një mall konstant për të shkelur kalldrëmin e rrugëve të Çairit me gjurmët e moshës djalosha dhe mezi pres të pi kafënë me Luan Starovën, Kim Mehmetin, Resul Shabanin, Rexhep Zllatkun, Fejzi Bojkun, Azis Pollozhanin, Halil Zendelin... Ndërsa në Tiranë, po ta kisha më afër, do të shkoja të paktën një herë në muaj. Përpos miqve të shumtë e të mirë, atje për çdo mbrëmje mund të zgjedh një ngjarje kulturore, një shfaqje në njërin nga teatrot, një koncert, një galeri, një përrurim libri a përvjetor figurash e datash dhe një ndejë me Z. Çelën, Sh. Sinanin, N. Zoton, B. London, I. Toçin, D. Çulin, S. Bejkon, Arian Lekën...

“ Kadareja e kishte fiksuar shikimin diku në një qoshe të tavanit të lartë dhe dukej sikur nuk ishte fare i pranishëm. Heshtja dhe prisja nuk e di sa kohë, kur m'u drejtua me një pyetje: “Ju jeni redaktor i disa botimeve te Rilindja e Prishtinës, nga autorë të Shqipërisë?” “Po”, - i them, meqë si redaktor në shtëpinë botuese “Rilindja”, ku isha bashkë me Ramiz Kelmendin dhe Nazmi Rrahmanin, kisha firmën në romanet e P. Markos, A. Abdihoxhës, J. Xoxës, e vazhdimin e mëtejme të bisedës së nxitur nga kjo pyetje e pasoi pyetja tjetër: “Dhe nuk gjete asgjë më të mirë për botim?”





VJESHTA E PËRJETSHME E DHORI QIRIAZIT

Yzedin Hima

Iharruar në atë fushëtirë të ngrirë në këmbë të maleve në Juglindje, Dori Qiriazit shëtit pasditeve më tepër brenda vetes se sa në atë mjedis të ngrirë. I zhytur në vetmi mediton për dashuritë e tij. Edhe ato, në çdo vjeshtë si gjethet, vdesin nga pak. Tej i shfaqen disqet pellgjeve në ngjyrë platini. Pastaj... Befas, diku, disku i ngrirë i pellgut kris...kris... Kris- tinë... I shfaqet ajo që ka fytyrën dhe kurmin e të gjitha femrave të botës, Kristina, me sy pellgjesh, ku ka ngrirë drita dhe loti i kristintë. Arti lind nga dhimbja, nga mungesa, nga malli.

Poezia “Dikur në vjeshtë” e Dori Qiriazit lexohet me të njëjtin emocion të leximit të parë, ndonëse kanë kaluar disa dekada që nga nyjëtimi i saj. Energjia estetike dhe kuptimore që përcjell ky tekst nuk hijezohet e zbehet nga koha, redaktorja e pamëshirshme e çdo lloj arti. Lexuesi vjetërohet, ndërsa teksti poetik, me të cilin ka kaluar çaste mahnitë në të ri të tij, ka ngeluar po ai: i ri, i pathënë, i sapothënë, magjik, i pandryshkshëm në të dy akset, atë estetik dhe kuptimor.

Shija që të leximi i një teksti të tillë, i tejkalon të gjitha shijimet, ku intelektu dhe shpirti njerëzor ndihet i mahnitur dhe i përkëdhelur, gjë që ndodh mjaft rrallë. Natyrisht të rrallë janë edhe tekstet, ku forma është edhe përmbajtje dhe përmbajtja është formë si tek poezia “Dikur në vjeshtë”. Ky tekst jo vetëm lexohet, por edhe kundrohet si një pejzazh i pikturuar mjeshtërisht me fjalë. Ky tekst, plot ngjyrë, ritëm, mall, dhimbje, ndarje, humbje, kujtesë, muzikë, lexohet, kundrohet dhe pëshpëritet si një melodi tejet shpirtërore, apo pëshpëritet nga lexuesi i radhës për vjeshtën dhe Kristinën e tij të humbur, por të patretshme, strukur a fshehur në kujtesë, por e shfaqur nga alkimia estetike e përjetimit të tekstit në mënyrë krejt personale e diskrete.

Teksti nis si një rrëfim: Dikur në vjeshtë kur pellgjet ngrijnë / dëgjova larg të sajnë zë. / Pikërisht në vjeshtë, kur ndodhin ndarjet e vogla dhe të mëdha, subjektit mendues i shfaqet Kristina, jo si imash, por si zë. Zakonisht njeriu magjepset nga pamja, jo nga zëri. Fizikanët thonë se zëri është i paasgjësueshëm.

Poeti me një lehtësi të pazakontë, me një thjeshtësi prekëse ndërton dy vargje, që rrallë i takon në poezinë shqipe: kaq shumë e desha unë Kristinën / sa nuk e donte njeri më. /

Po cila është kjo energji dashurie, që shterron jo vetëm burimin, subjektin mendues, por edhe objektin, Kristinën?! Mund të jetë rrjedhoja e një dashurie sublime. Aq e fortë ka qënë, sa që ka krijuar një aureolë rreth Kristinës dhe askush nuk guxon t’i afrohet dhe të përballet me të. Asnjë burrë nuk mund t’i afrohet Kristinës dhe t’i shfaq dashurinë e tij të vocërr. Do të dukej krejt i padenjë për të merituar Kristinën, të cilën dikush para tij e kishte ngritur në lartësi të tilla dashnie, sa që çdo mëtonjësi do t’i merreshin mendtë dhe nuk do të mund të ngjitej aq lart.

Dy vargjet e tjerë të këtij teksti të sjellin ndër mend se Kristina e mrekullueshme, me bukuri ngjethëse dhe virtyte hyjnore e ka zhvlehtësuar dhe varfëruar aq shumë mjedisin rreth e rrotull, sa që subjekti mendues klith i pashpresë: e dashur kaq më ish Kristina / sa kurrë s’desha njeri më. /

Mos vallë një dashuri e tillë sublime robëron, “vret” bartësit e saj, duke i dënuar ata pas ndarjes me mosdashuri?! Zbehja e objekteve të tjerë, njerëzve, peizazheve, stinëve dhe zëvendësimi i tyre vetëm me një pamje, imazhin e Kristinës, zërin e saj, mos vallë është patologji?

Që t’i japësh përgjigje kësaj pyetje duhet të provosh atë që ka provuar subjekti mendues i këtij teksti. Në tekst nuk e gjejmë portretin e Kristinës, nuk ka asnjë fjalë për bukurinë e saj, por gjendemi para rrjedhojës, efekteve të saj. Aq magjepse ka qënë Kristina, sa që mjedisi rreth saj shkretohet, vulgarizohet, humb vlerën, bëhet i padenjë për t’u dashur, ndërkohë që ajo mungon.

Dori Qiriazit është mjeshtër i rrallë i fjalës, ku fton imagjinatën e lexuesit për të krijuar portretin e Kristinës apo të Kristinave, sipas aftësisë perceptuese të çdo lexuesi. Pikërisht, enigma e portretit të Kristinës dhe forca e saj për të rrënuar gjithçka rreth saj, e bën të mistershme bukurinë e saj.

Dihet, që dashuria është energji pozitive. Po çfarë mbetet pas? Mbetet Kristina, e shndërruar në zë, që sa herë fryn suferina, vjen e i hyn në vesh, i depërton në shpirt subjektit mendues, duke ia bërë më të bukur, më të dhimbshme dhe më të trishtshme vjeshtën. Subjekti mendues, poeti, është shndërruar në fjalë, në tekst poetik, ku koha është e pafuqishme për ta kthyer në asgjë.

CARMINE ABATE njëri nga pjesëtarët e plejadës së shkrimtarëve bashkëkohorë të letërsisë arbëreshe, por që nuk ngjan me asnjërin. Ai është një personalitet i dijes dhe kulturës arbëreshe dhe asaj italiane, i cili ka një vend të sigurt dhe të dukshëm në mozaikun tematik, shkencor, kulturologjik dhe të letërsisë bashkëkohore arbëreshe, i cili ka “adaptuar” një angazhim individualist për të qenë në qendër të vëmendjes së kulturës italiane, për të nxjerrë në pah kulturën dhe fenomenin arbëresh në këtë kulturë të gjerë dhe asimiluese. Në kushtet dhe rrethanat e shumëfishta në të cilat kultura dhe letërsia arbëreshe është bërë e pranishme në Horën e arbëreshëve të Italisë, me dashje pa dashje tendenca për t’u përvetësuar ka qenë dhe vazhdon të mbetet edhe në kohët tona moderne.

Karmine Abate është produkt i këtij mjedisi dhe “relacioni” kulturor - historik, jo vetëm pse ai është arbëresh dhe ka një vetëdije jashtëzakonisht të rëndësishme për gjithçka ngjan me mjedisin në të cilin ai ka lindur dhe është rritur, po dhe për shkakun e dukurisë në të cilin ai bën pjesë. Abate ka lindur në një kohë, kur fenomeni letrar në letërsinë bashkëkohore italiane dhe atë europiane nga arbëreshët ishte konfirmuar që nga Solano, Vorea Ujko, Perrone, Di Maxhio, Di Modika dhe një numër i konsiderueshëm shkrimtarësh, të cilët kishin arritur të krijonin komunikimin e nevojshëm të këtij “rizgjimi” në kushtet e reja të zhvillimit të letërsisë.

Më shumë rëndësi në këtë plejadë ka intelekti dhe “praktika” krijuese në kushtet e reja për të vijuar letërsinë shqipe në kulturën dhe qasjen moderne të letërsisë. Gati të gjithë shkrimtarët e kësaj periudhe, kanë një tipar të përbashkët dhe të qenësishëm, që lidhet fort me sjelljen në vëmendje të lexuesit, por në kushte të reja urbane dhe metodologjike letrare të mjedisëve, kujtimeve, historive dhe pasuri të tjera të kulturës popullore arbëreshe. Në këtë aspekt, pa dyshimin më të vogël, grupi i krijuesve arbëreshë në shekullin XX mund të quhet një plejadë e artë.

Duke qenë ndryshe të tjerëve, por njëri nga ata, Karmine Abate nuk i ka ikur kurrë raportit që çdo shkrimtar arbëresh i kësaj periudhe ka pasur me orientimin që kjo letërsi ka marrë në rrethanat e reja. Aftësia dhe talenti i padiskutueshëm i këtyre shkrimtarëve qëndron në mesazhin bashkëkohor që ata kanë arritur të krijojnë nga subjekte dhe motive arbëreshe, të cilat dhe në kushtet e veçanta të një krijimi modern, ta bëjnë komunikues dhe të dëgjueshëm nga lexuesi dhe mendimi kritik dhe studimor. I gjendur në këto rrethana interesante dhe Karmine Abates i është dashur punë më shumë, bashkë me poetët dhe shkrimtarët e moshës së tij, për të gjetur forca, aftësi dhe talent të madh për të krijuar individualitetin dhe profilin e vet.

Karmine Abate (1954) ka lindur në Karfici, në një komunë arbëreshe në Kalabri të Italisë, një nga qendrat e njohura të populluara që nga shek. XV apo më parë nga arbëreshët, që ikën nga Arbëria, e cila u pushtua nga ushtritë osmane. Si një koïncidencë, më së shumti ndër arbëreshët e Italisë, ka qenë një aspekt i njohur, pasi një pjesë e madhe e tyre, pas migrimit të parë, ndoqën disa migrime të tjera, deri në Brazil dhe në Argjentinë, Abate provon dhe ai migrimin, një fenomen vërtet i dhimbshëm e dramatik dhe në shumë raste tragjik, në fillim në Valtelina dhe më pas në qytetet veriore të Gjermanisë.

Në këtë kohë Abate ishte në një moshë të njomë, njëzetedyjeçare, por kishte migruar me një pjekuri jo të zakonit, me një kulturë të nxënë në kushtet e vendlindjes së tij, po dhe të shkollës, pasi ai kishte mbrojtur diplomën me komentin e Bokaçios, mbi “Komedinë Hyjnore” të Dantes, një nga mundësitë më të mira për një njeri të kulturës, letërsisë dhe të qytetërimit botëror. Të kuptuarit dhe të gjykuarit në këtë moshë të Dantes dhe kryeveprës botërore, nuk ishte një gjë e zakonshme, që përvese përbënte një fat të madh, shpërfaqte dhe një vështirësi po të këtij niveli.

Gjermania ishte një mundësi dhe një vizion tjetër për Abaten e ri. Toka që kishte prodhuar ngjarje madhore, kishte lindur lëvizje të kulturës dhe letërsisë, filozofisë dhe shkencës, ishte një rrethanë tjetër për shkrimtarin e ri, i cili, siç mësohet e kishte kuptuar mjaft mirë. Në këto rrethana, Karmine Abate arrin të depërtojë në mjedisin gjerman, duke qenë docent i gjuhës italiane në shkollat gjermane, me ç’rast i krijohet mundësia të bëhet i njohur dhe i vlerësuar pozitivisht. Në migrimin drejt Gjermanisë, Abate ushtron dhe punën e sociologut, gjithashtu shkruan dhe tregime interesante për jetën me motive të emigrantëve në këtë vend.

Qoftë për shkak të talentit të spikatshtëm, por dhe për rrethanat në të cilat është nxënë kultura dhe marrëdhënia e tij me letërsinë dhe me mesazhet që ai i ka drejtuar lexuesit dhe kohës, kritika dhe studiuesit, madje kritika

CARMINE ABATE DHE MODERNITETI I PROZËS SË TIJ

Prof. Dr. Bardhosh Gaçe

e specializuar dhe e paanshme, ka diktuar tek Abate një fenomen letrar interesant, por pa e shkëputur atë nga të qenit e tij një shkrimtar italo- arbëresh. Madje, për një rrethanë të tillë, apo për shkak të opinionit dhe mundësisë së komunikimit që ai i kërkon krijimtarisë së tij, është e rëndësishme të shënohet opinioni i tij mbi këtë “larmi” gjuhësor, pasi në një pjesë të prozës së tij ka një pleksje të arbërishtes, italishtes dhe gjermanishtes. Lidhur me këtë praktikë ai ka thënë: “Ideali im do të ishte të përdorja disa gjuhë njëkohësisht. Zgjedha italishten, një gjuhë për mua gati- gati e huaj, sepse doja ta

përshkruaja arkipelagun, të cilit i përkas me një farë distance, por pa ndonjë krenari boshe dhe pa sentimentalizëm. Tashmë jemi në një botë shumëkulturore”.

Është një opinion mjaft interesant, që përkon me kohën në të cilën ai shkruan, me rrethanat në të cilat ai duhet të imponohet dhe të kërkojë vëmendjen, është një iniciativë, që në pamje të parë duket se i kundërvihet një praktike të gjerë arbëreshe, të poetëve dhe shkrimtarëve të këtij brezi që shkruanin arbërisht dhe e quanin detyrë këtë praktikë, por duke e parë në një farë distance dhe me qetësi, Abate zgjedh një front të vështirë për të pasur më shumë efekt dhe komunikim në këtë kohë shumëkulturologjike. Në rrethanat e të shkruarit në gjuhën italiane, të cilën ai e quan një gjuhë të huaj, mundësia e komunikimit për mesazhin që mbart dhe ngërthen krijimtaria e tij është më e madhe.

Karmine Abate ka shkruar poezi dhe prozë, por edhe shkrime apo punime të natyrës kulturologjike dhe publicistike. Libri i parë poetik i Abates është i vitit 1977, i botuar në Romë dhe titulluar “Në labirintin e jetës”. Dhe pasi u largua në Gjermani, ai shkroi dhe krijoi vazhdimisht. Në vitin 1984 në Gjermani publikon një libër me tregime. Si gjithë shkrimtarët dhe intelektualët e tjerë arbëreshë, Abaten e ka shqetësuar tema e arbëreshëve,

veçmas e atyre në Kalabri dhe në të gjithë aventurat e emigrimit. Po në vitin 1984 boton në Gjermani librin “Gjermanezët” bashkë me Meike Behrmann, të shoqëruar me një nëntitull të shpjegueshëm “Historia dhe jeta e një komuniteti kalabrez dhe e emigrantëve të tij”, një vepër që dy vite më pas u ribotua dhe në Itali.


Në vitin 1986 Abate boton një tjetër libër të titulluar “Në këtë tokë gjetiu”, një titull interesant dhe intrigues, në të cilin ka përmbledhur tekste letrare të emigrantëve italianë në tokën gjermane. Në vitin 1991 sheh dritën romani i tij i parë në italisht të titulluar “Il ballo tondo”, i cili u përkthye edhe në gjermanisht. Abate falë kulturës dhe dijeve

të mira arriti shpejt të depërtojë në mjediset kulturore dhe ato shkencore. Punon në shtëpinë botuese “Pelegriini”, i cili drejton kolanën e rëndësishme të botimeve në këtë shtëpi botuese “Biblioteca Emigracioni”, ndërkohë në këtë kohë botoi dhe dy përmbledhje poetike të titulluara “Çerdhet” dhe “Prej nesh”.

Abate është një poet lakonik dhe i shkathët në paraqitjen e realitetit shpirtëror. Poezia “Djegia e ëndrrave” ka një realitet ekzistencial, të cilin poeti e prek me një lloj peneli të shpejtë dhe vizatues poetik. Ai shkruan: “Në zjarrin e ditëve të shkuara/ digjeshin ëndrrat tona/ të lufrave pa gjak.” Pastaj: “Për ndë udhë të verës/ luajim pata- pata/ mu në vapë/ e mosnjeri s’doj të vdis.” Dhe: “Sot vdesmi. Larg. /Të shtrydhur si mizat/ në hon.” Për ta mbyllur poezinë me një definicion të qartë: “Me motin/ me motin dërmohet/ fuqia për luftë.” Është një poezi e shpejtë dhe konturale e një gjendjeje të trishtueshme, mjafton të kuptosh fjalorin që përdor poeti në vargjet e shkurtra dhe pa ndonjë angazhim harmonik. Bëhet fjalë për një luftë, e cila ka nisur dhe është zhvilluar që herët dhe ka mbetur e tillë. Një luftë pa gjak. Është rrugëtimi dhe gjendja në të cilën janë gjendur emigrantët në përgjithësi dhe arbëreshët për të cilët flet poeti. Për këtë ai është mjaftuar ta tregojë vetëm përmes një fjale në strofën e tretë, fjalën “larg”, e cila në letërsinë arbëreshe është një nga leksemat më të përdorura dhe më të kuptueshme, thënë ndryshe “larg atdheut të të parëve”, “larg Arbërisë”, ku njerëzit janë si mizat, vdekja e të cilave nuk trishton njeri.

As Abate në krijimtarinë e tij nuk i është shmangur ritualit të vjetër arbëresh. Bregu i detit mbetet një vend ku tregohen dramat dhe shfaqet malli, ndjehet mungesa dhe ngrihet muza e poetëve dhe rapsodëve që nga rrëfimi i plakut Balë. Poezia e Abates, e titulluar “Drita e gushtit fjet gjuhën e erës” është një peizazh interesant, që pavarësisht veshjes poetike të stilit modern të perceptimit poetik ka një thelb dhe një simbolikë të pazhbëshme, që lidhet me bregun e detit, që sheh, dhemb dhe kujton atdheun e të parëve. Poeti shkruan: “Buzëqeshje sysh të ujit. / Të dejtëve në breg/ dhe një rrokullisje e ngadalshme/ e gurëve në suvalëza/ faqe vrejtur/ për lojën prapa ballukes/ së lagur me diell/ te këmbët e tua/ një libërth i rimtë/ dhe një notes i zi/ mbytur në shurë/ në fotografinë shkëlqyese/ të dritës gushtore/ që fjet gjuhën/ e erës/ pjesë e kaluarës së largët. ”

Është një poezi e organizuar mjeshtërisht si një moment psikologjik i poetit. Një poezi njëshkolonë, si një frymëmarrje, e cila, për shkak të simbolikës në fillim duket e padepërtueshme, por përmes shkallëzimit rritës ajo kuptohet fare mirë. Është një motiv arbëresh, i interpretuar dhe i estetizuar në një stil konvencional, me pak leksema letrare. Brendësisht është një poezi komunikative, e gjerë, brenda së cilës ka një kohëgjërësi të shtrirë në momente psikologjike dhe të përjetueshme. Në fund të fundit, është i njëjti zakon, i njëjti rit, në breg të detit, që nga “e kaluara



e largët”, Arbëria vazhdon të shihet dhe të ndjehet mall për të, madje me një trazim eksistencial.

Një profilitet të spikatur Karmine Abate ka shfaqur në prozë dhe veçmas në gjininë e gjatë të saj, atë të romanit. Shkrimtarin Abate në gjuhën shqipe mund ta lexojmë dhe ta njohim përmes dy romaneve, për të cilët kritika e avancuar dhe moderne italiane ka shkruar me objektivitet për një shkrimtar bashkëkohor dhe mjaft intrigues. Karmine Abate arriti të hyjë shpejt në gjininë e prozës së gjatë, dhe kjo shpjegon një fenomen letrar të rëndësishëm dhe për letërsinë arbëreshe. Duke pasur një shqisë inteligjente, një aftësi për t’i perceptuar dhe përdorur kohët mjeshtërisht, Abate ka arritur të konvencionalizojë një metaforë moderne në prozën e tij. Romani “Festa e kthimit”, sjellë për lexuesin shqiptar në vitin 2010 nga Shtëpia botuese “Toena”, është një roman i ngritur mbi një strukturë moderne, ku reflekton një rrëfim racional integruar i mjedisve dhe situatave psikologjike, ndërsa personazhet janë mbartës mesazhesh, të cilët shkrimtari i skalit herë përmes stilit dhe përvojës klasike dhe herë të reflektuar nga mjedisi dhe “ngjarja”.

Vepra më e rëndësishme e Abates është romani i njohur, që në shqip ka ardhur me titullin “Shtegtimi i unazës”, në përkthimin mjeshtëror të të ndjerit Dritan Çela, nga botimet “Toena” Tiranë. Romani është ndërtuar me një mjeshtëri të jashtëzakonshme, i ngritur mbi detaje interesante, mbi një mekanizëm që zakonisht kanë përdorur mjeshtërit e realizmit magjik. Kritika bashkëkohore e letërsisë italiane, ka arritur deri aty sa Abaten e kanë krahasuar me Markezin. Në një strukturë tregimtare romaneske, duke pasur një lidhje të fortë dhe një plagë të thellë të trashëguar nga të parët e tij, Abate ka arritur që mjedisin arbëresh ta sjellë në romanin “Shtegtimi i unazës”.

Njëra nga figurat më mitike dhe më të njohura në baladën shqiptare të hershme, e cila glorifikon mjeshtërisht një nga tiparet qenësore të shqiptarëve, mbajtjen e fjalës së dhënë, baladën e Dhoqinës me të vëllain Konstantinin, Karmine Abate, ka arritur ta sjellë në një version modern. Në dhjetëra detaje me të cilat e ka ndërtuar romanin në fjalë, mitin dhe baladën e kthimit, por në një breg me të tashmen, ai zgjedh personazhin e tij Konstantinin. Konstantini i Abates ka historinë e së ëmës, Elenës, me të atin, Franceskon. I ardhur në këtë botë pas dy vajzash, i rritur me historinë e martesës së prindërve pas një historie si në baladë, Konstantini kërkon të besojë atë, të cilën e ka nën lëkurë, që është dhe historia e të parëve.

Romani është një vepër komplekse, që përveç një strukture plotësisht moderne, në vetvete përbën një sjellje të re të shumë elementëve të tjerë të natyrës psikologjike dhe dilema që zakonisht ka shtruar letërsia dhe psikologjia moderne, mitet dhe aktualiteti. Mjaft mirë përmes kësaj historie të shkruar nën një temperament psikologjik ekzistencial, lindin dilemat e rëndësishme se, si mund të mbetet e shkuara tek ne, a mund të jetojnë e kaluara me të sotmen, a bëhen bashkë ato? Në këtë ngrehinë romaneske Abate ka bërë bashkë mitin dhe realitetin, duke sjellë në vëmendje “njeriun udhëtar”, që përkon me identitetin e tij dhe historinë e të parëve të tij.

Siç kuptohet, romani ka brenda tij një dimension kohor, ka disa kohë që përzihen me njëra - tjetrën. Duke pasur një kohë interesante kur dhe u botua romani i Abates (1991) në këtë kohë ka një përkim interesant që lidhet me thellësinë e identitetit të shkrimtarit. Mijëra shqiptarë ikën nga Shqipëria për të mësyre Perëndimin. Ky lloj personazhi “kolektiv”, pasi ikja e mijëra shqiptarëve nga vendi i tyre, në letërsi përbën një lloj personazhi kolektiv, duket se ngjante dhe me Konstantinin e Abates. Ai kishte lindur në një natë rrebeshi, ku i ishte shembur shtëpia, duke e detyruar Franceskon të shkonte në Gjermani për të siguruar të ardhura që të ndërtonte shtëpinë përsëri.

Romani ka një pleksje të thellë dhe shumë interesante të figurave mitologjike nga njëra anë, po dhe të kohëve që shkojnë e vijnë. Ka një lidhje të brendshme me përrjetimin dhe jetën e vetë shkrimtarit. Ai na kujton se të gjithë (arbëreshët) kanë nevojë për “Horën” fshatin e tyre, të cilët kudo gjenden të mund të kthehen, duke e bërë këtë fakt si një moment për t’u ndjerë vazhdimi i botës. Në këtë mënyrë Abate arriti ta fusë në gjuhën e letërsisë botërore atë që dikujt mund t’i duket si historia e fisit të tij, e fshatit të tij, por Abate ka arritur të ndërtojë një metaforë universale, për shkak të lëvizjeve të njerëzve, që lindin diku dhe e kalojnë jetën “jo në gjuhën e tyre”.

Karmin Abate si një nga prozatorët bashkëkohorë të letërsisë arbëreshe, ka dhënë për lexuesin shqiptar dy romane, të titulluar “Shtegtimi i unazës” dhe “Mes dy detesh”. Në prozën e tij, ai ka ruajtur raporte me temën e njohur të kësaj letërsie, por pa iu shmangur dhe trajtimit të temës bashkëkohore, në të cilën mishërohet dhe ajo tradicionale. Duke qenë arbëresh, përveç këtij pozicioni

të njohur, autori sheh realitetin bashkëkohor të njeriut të sotëm në Italinë e Jugut, nga këndvështrimi i një arbëreshi të sotëm, çka ndihmon në bashkëkohësinë e trajtimit të kësaj teme.

Abate mëton të shpalojë në një subjekt të gjerësishtëm një çështje, që pavarësisht vjetërsisë kohore-historike, në çdo moment historik, ka pasur prerjet e veta, brenda së cilës, universalisht, duhet kërkuar dhe fati i arbëreshit, fati i shqiptarit si dramë, si tragjedi dhe si mbijetesë. Anët e kohëve lidhen në cepat e tyre, dhe pse letërsia e tij, kryesisht proza, është e një krijuesi arbëresh, por që trajton problemet e njeriut të sotëm të Italisë së Jugut, në këndvështrimin e tij, duke e pleksuar atë dhe në aktualitetin kohor italian.

Në thelb Abate duket se merret me një lloj “dileme” në mjedisin arbëresh dhe atë italian, e thënë ndryshe “të ikësh i detyruar, prej hallesh dhe prej dëshpërimit, nga toka jote e të shkosh si emigrant në vendet e tjera të zhvilluara të botës perëndimore, të qëndrosh e të luftosh me të gjitha forcat reaksionare, që mbajnë prej shekujsh të skllavëruara energjitë e kalabrezit, përfshirë këtu dhe ato të arbëreshit.” Abate, siç dhe kuptohet, është një prozator modern, në krijimtarinë e të cilit ka një qasje universale të historisë së njerëzimit, e cila dhe tek proza e tij është e pranishme në dy çështje ekzistenciale; atë të largimit dhe atë të “detyrimit”. Pikërisht këtu fshihet dhe fati i kalabrezit (d. m. th i arbëreshit), që në diçiturat historike ka ndodhur në të gjithë globin njerëzor dhe tokësor, në metaforën universale të të cilës ai gjen veten dhe njerëzit e tij.

Në këtë kontekst të gjerë historik, social dhe rendesh politike, pasi fati njerëzor gjithmonë “qerthullohet” në rende të caktuara politike, Abate ka meritën prej prozatori dhe vëzhguesi të hollë të gjëje dhe të “elaborojë” pamjet arbëreshe, fate dhe fatalitete arbëreshe, tek të cilat, që në krye të herës gjen energji shpirtërore, që ka ndihmuar deri në misticitet në ruajtjen e një lëvizjeje për përparim dhe zhvillim, pa harruar asnjëherë identitetin. Abate nuk harron të kujtojë dhe të vendosë në referencë, siç ka ndodhur gjithmonë, trashëgiminë historike, kulturore, gjuhën, folklorin, etnografinë dhe “Motin e Madh”, pra Skënderbeun, si një nga simbolet që ka ushqyer një krenari dhe trashëgimi etnopsikologjike tek arbëreshët për të ndërtuar një lloj qëndrese që i ka përballuar kohëve.

Në këtë refleksion të kuptueshëm, Abate shqyrton imtësisht në struktura romaneske çështjet e integritetit të arbëreshit të Kalabrisë, jo vetëm si një realitet i pranishëm që herët në jetën e tij, që nga ardhja e tij para pesë shekujsh, por edhe atë të kohës globale, ku ka një prani dramatike, ajo e kontaktit të emigrantit të varfër me qytetërimin tërësor. Abate, duke qenë një vëzhgues i hollë, kupton mjaft mirë kontrastin e thellë të emigrantit, i cili rrezikon



të mos vendosë asnjë llojë lidhjeje në qytetërimin modern (pasi në të shumtën e herës, ai nuk konsiderohet prej këtij qytetërimi, përveçse shfrytëzohet prej tij), duke i fshirë atij identitetin. Një nga dramat e emigrantëve në botë, si më herët dhe sot, është humbja dhe zhdukja e identitetit të tyre. Një fat të tillë e pret dhe arbëreshin e Kalabrisë.

Në romanin “Mes dy detesh” Abate merret me aktualitetin e shoqërisë moderne të globalizuar dhe të njeriut që nuk largohet emigrant, por vendos të qëndrojë në mjedisin ku ka lindur, ku ka mjedisin kulturologjik dhe marrëdhëniet që i sigurojnë atij qenësinë si vazhdimësi e identitetit të tij. Në të vërtetë, kjo është një refrencë historike e arbëreshëve të Kalabrisë e përdorur mjeshtërisht në subjektin e romanit, fikshenin e tij, thënë ndryshe. Në këtë qasje Abate kërkon të dalë nga rrethi i arbëreshëve, për t’u përfshirë në rrethin më të gjerë të kalabrezëve, në fatin e tyre historik, me ç’rast kërkon të trajtojë dhe problemet e një komuniteti të mirëfilltë kalabrez.

Në roman tipizohet fati i arbëreshit të ikur, që ngjan mjaft me fatin e të gjithë të ikurve të tjerë në botë. Por në arsyetimin e tij ka dhe një qasje tjetër, ai shtjellon fatin e arbëreshit, i cili kërkon të qëndrojë, po i tillë është dhe ai i kalabrezit që kërkon të qëndrojë. Xhorxho Belushi (personazhi i romanit) e përcjell këtë mesazh, me të cilin duket se ndërtohet dhe metafora e romanit. Fati i pjerrët i këtyre personazheve të kujtojnë Sizifin në mundimin e tij të përrjetshëm, një mit mitologjik, që tek Belushi rrok vetëm kohën e tij, duke mos qenë i përrjetshëm.

Xhorxho Belushi është një personazh historik në një mjedis historik të identifikuar. Me këtë rast shkrimtari arrin ta afrojë realitetin me njerëzit, duke e bërë të prekshëm fenomenin. Nëse Belushi është i detyruar t’i “pranojë” “traditat” dhe “rregullat” e mafies, e cila kundërshton përparimin, e eliminon atë kur ai është pengesë për këtë “rregull”. Në rrjedhën e zhvillimeve shfaqet nipi i tij, i cili në mjedisin kalabrez është kalabrezi-emigrant, i cili njeh një botë tjetër dhe që është më i vetëdijshëm për atë që kërkon t’a arrijë.

Romani ka një konflikt të brendshëm dhe të pranishëm dhe pse autori nuk e shfaq atë. Në krahun e maskuar janë forcat regresive, të cilat pengojnë zhvillimin që mëton gjithë përplasja për zhvillim. Abate përdor mjetet e tërthorta të komunikimit në këtë rast, siç është ajo e triumfit të veprimtarisë krijuese të Xhorxho Belushit, vepra artistike e të cilit shfaqet para masës së gjerë të njerëzve të thjeshtë, ndërsa në anën tjetër jepet përfaqësuesi i lartë vendor i errësuar dhe i priër nga disa djem të rinj dhe të fuqishëm, me fytyra dhe syze të zeza. Kontrasti është i dukshëm dhe publik. Autori preferon të përdorë kontrastin “kinematografik” për t’a kuptuar këtë.

Proza e Abates është prozë jetësore. Ajo mishëron një farë realiteti të jetuar dhe të prekshëm nga njerëzit. Romani inkurajon shtresat progresive dhe masat e gjera të popullit, se para tyre ka sfida, qoftë dhe me një risk vdekjeje (në konflikt me forcat regresive), për ta mbajtur shoqërinë nën pushtetin e nënshtrimit dhe skllavërimit, përballë të cilave duhet fituar. Mesazhet e Abates duken të thjeshta, të kuptuara mirë, por që kanë një rëndësi publike dhe sociale. Ato i drejtohen popullit, pavarësisht kush i mishëron ndër personazhet e tij, në romanin “Mes dy deteve” dhe “Shtegtimi i unazës”.

Në opinionit kritik romani “Shtegtimi i unazës” është përcjellë me një seriozitet të pazakontë. Kështu në “La Stampa” Bruno Ventali shkruan: “Karmine Abate, një shkrimtar italo-shqiptar, është një zbulim i këndshëm letrar. Romani i tij i parë “Il ballo tondo”, tregon për herë të parë historinë e arbëreshëve të Italisë, dhe e bën me po atë realizëm magjik të Markezit e të shkrimtarëve të mëdhenj amerikanë – jugorë.”

Një vlerësim të një niveli po kaq mbështetës bën dhe Mikele Xhoia në RAI 3, kur thotë: “Romani, tashmë pranë botimit të dytë, i recensionuar në mënyrë entuziaste nga shtypi italian, është bërë një pikë referimi për këdo që ka për zemër fatet e minorancave... Abate nuk i pranon ankimet... Në roman nuk ka nostalgji për botën e bukur të lashtë, por përmes historish mitike e fantastike, shpëtohet dinjiteti i lashtë i kulturës arbëreshe.” Vlerësime të tjera kanë ardhur nga “Corriera della Sera”, studiuesi i njohur Xuzepe Galxerano, “Corriere d’Italia”, “La Stampa” dhe vështrime të tjera kritike e studimore, duke e dimensionuar atë si një shkrimtar të rëndësishëm jo vetëm për kulturën arbëreshe - shqiptare, po dhe për letërsinë italiane dhe atë europiane.

Abate është një nga prozatorët e letërsisë së sotme, i cili kërkohet të studiohet dhe të eksplorohet me kompetencë shkencore. Pavarësisht talentit, modernitetit, bashkëkohësisë, ai nuk iu shmang kurrë historisë së Kalabrisë, vendlindjes dhe qenësisë së tij arbëreshe. Ky është një fat i madh për arbëreshët dhe kulturën shqiptare.

1.

Pas njëzet e ca vjetësh prej botimit të parë, u bëra mbarë të lexoj “Piramida” e I. Kadaresë, për një sërë arsesh: nuk kam qenë aty kur është publikuar te “Rilindja Demokratike”; kur jam gjendur në Tiranë ose më ka dalë nga mendja, ose edhe nuk e kam gjetur kur e paskam kërkuar.

Mirëpo shpejt u ndjeva me fat që nuk e paskam lexuar asokohe; nuk do të kisha patur qetësinë e duhur atëbotë për ta lexuar këtë libër siç duhet, siç edhe vetë autori, cildo autor, ma do mendja, pret të lexohet, si shkrimtar, si estet, e jo si tribun i vegjëlisë apo bacë i dherave ku shkelën të parët.

Edhe më shumë iu gëzova edhe vetes sime, lexuesit në mua, të cilit nuk i duhet më tashmë, nuk po kërkon më të gjejë mes rreshtash kumte sekrete disidente e as të qëmtojë alegori të largëta apo të afërta, ndonëse ato mund të gjendeshin e gjenden aty me shumicë e pa shumë mundim. Por nuk po dua më të lexoj asisoj dhe i gëzohem leximit të një libri që vjen nga Mëmëdheu sikur dëgjimit të një simfonie, leximit estetik të tij. Nuk dua, jo se i trembem përballjes me të kaluarën, as se kërkoj ta harroj atë; thjesht, përvoja jetësore më ka mësuar të mos merrem më me gjëra, shtjellën e së cilave nuk e ndikoj, nuk e ndryshoj dot.

Ka boll padrejtësi e dhimbje e luftë e ligësi kjo botë, mirëpo duhet bërë kujdes, e këtë paskam mësuar nga disfatat, me dozën e përditshme të helmit që merr nga media, nga njerëzit, nga lajmet, nga gjithçka – fundja, atë që po kërkojmë ta arrijmë për të tërë, duhet të shohim ta vëmë në jetë ne vetë të parët: ndonjë shëtitje të qetë, ndonjë bisedë të këndshme me miq, ndonjë libër të mirë, ndonjë pikturë të bukur e ca muzikë të mirë; për këtë jetohet fundja, apo?

Me një fjalë, i gëzohem faktit, që marr një libër në dorë e nuk më duhet të pyes: »Çfarë ka dashur të na thotë autori me të?«, pyetje kjo mbase në kohëra totalitare mëse e këshillueshme, por jo për lexuesin në liri, bashkësi kjo ku mund ta llogaris veten, për fatin tim të keq apo të mirë, vetëm përgjysmë.

2.

Para disa vitesh, ndërsa gjendesha në Tiranë, po bisedonim me dy miq në një kafene diku pas piramidës. Asokohe zhvillohej debati në parlament, për prishjen apo ruajtjen e saj, të cilin nuk e kisha ndjekur në hollësi, porse për të cilin isha deri diku në dijeni, pasi nuk i shpëtoje dot; të gjitha gazetatat online e kishin në faqen kryesore e mund t’u bishtnoje shkrimeve, por jo titujve, që të goditnin sapo klikoje ndonjë faqe.

Shpejt vura re në Tiranë se tema kish zënë vend edhe në bisedat e përditshme; tre a katër të njohur që kisha takuar më kishin treguar idetë e tyre për të; të dhathtët qenë për prishjen e saj, të majtët për rehabilitimin dhe ruajtjen, madje pata dëgjuar edhe të tjerë që flisnin për vlerat e saj arkitektonike. E pasi mbaronin së shfryri dufin e tyre, ndoshta mllëfin, me të kaluarën, me shtetin, me botën, në mos me veten e tyre, por edhe me tjetrin në mënyrë të pandërgjegjshme, që në këtë rast i binte të isha vetë, kujtoheshin pastaj se jam i fushës dhe, për të patur ndoshta edhe alibinë e monologut që kishte paraprirë, ndërmendeshin të më pyesnin së fundmi se çdo të bëja unë me të, me piramidën domethënë.

Njëri nga miqtë e mi, pasi qemë pyetur me si jeni, e nga familja, e të gjithë mirë, hapi edhe ai këtë temë, duke e treguar me dorë në një gjest domethënës ngrehinën.

»Unë them ta bëjnë muze për të përndjekurit«, tha dhe, pasi kishte argumentuar gjerë e gjatë se pse ajo duhej të bëhej e tillë, muze pra, nuk harroi edhe ai të na pyeste ne dy të tjerët se çdo të bënim me të, nëse do të mundeshim.

Ashtu si edhe të tjerët, ai e shtroi pyetjen bardhezi, duhej prishur apo duhej mbajtur, por edhe nuk ngjante fort i interesuar për përgjigjet që i binte të merrte prej nesh, gjykuar nga shprehja e vagullt e përhumbjes që i ra në fytyrë, kur mbaroi së foluri vetë e që i bie shumëkujt në Shqipëri përgjatë bisedës, kur tjetri kërkon ta dëgjojnë atë vetë, porse pak i bën për të dëgjuar të tjerët.

»Mua kjo gjëja«, ia nisi miku tjetër, »sidomos e parë këtej nga pas, më ngjan me të pasmet e një shqiptonje të bastarduar prej betonarmeje, e shartuar me një yll, po prej betoni, një farë kimere e neveritshme e dhunës me absurditetin, e ateizmit me paganizmin stalinist; me një fjalë: po të ishte për mua e nëse do të mundesha, do ta kisha shkullur qysh tani, si të thuash, nuk do t’i lija dy gurë bashkë. Më kujton, kur e kundroj, një kërmë ndanë rrugës, por edhe më shumë akoma, - po të mos qenë

PIRAMIDALE


Nga Arb Elo

ropullitë, që i kanë mbetur ende, dhe mizat që i vijnë vërdallë (ca njerëz që hipnin e zbrisnin lart e poshtë), si edhe grafititë,- më kujton pra skeletin e një dinozauri, një tireksi, që, falë Zotit, nuk është më gjallë, përndryshe do të na kishte shqyer të gjithëve. Mendo sikur kjo godinë të ishte e mirëmbajtur e bashkë me të edhe diktatura e tash të kishim mbi krye brezin e tretë të diktatorëve, se si do të na dukej.

Do ia hiqja rropullitë fare, do e lija veç skelet, si mbetjet e një ndërtese në Hiroshima, funksioni i së cilës nuk po më kujtohet, por që është lënë në mes të qytetit, tashmë modern, si përkujtimore e bombës atomike që u hodh aty; bomba që hodhi Enver Hoxha këtyre anëve, trutë e gomarit që u hodhi njerëzve, është e njëjta gjë,

pak a shumë. Kinse simbolizon një shqiptonjë që bëhet gati të çohet në fluturim, porse mua më ngjan me një merimangë.

Më erdhi për të qeshur me ç’tha, ndërkohë që bashkë me mumien e pagënë të Hoxhës, m’u asociua kushedi pse me një skenë nga ”Zoti i unazave“, ku një merimangë gjigante e mbështjell personazhin me fije, e bën kokon. M’u përshfaq diktatori i mbështjellë ashtu me fasha, kur u bënë homazhet diku te Kuvendi Popullor (apo paska qenë Instituti i Arteve?), i mbështjellë si kukurec, si plënc i qepur, me penjë mëndafshi, por më kishte ardhur radha për të thënë diçka e të dy po prisnin të flisja, jo pa ligësinë e kujt pret që ti të gabosh, të bësh gafën, rastin për të të zënë gafil me fjalët e tua,- kështu të paktën më



ngjau e kishte fort të ngjarë që ligësia që po projektoja tek ata të ishte ligësia ime, që buronte nga pafuqia që të zë kur Qoftëlargu largohet nga kjo botë mirë e bukur e pa i hyrë gjemb në këmbë, – sidoqoftë e zura fillin dhe u pozicionova menjëherë në pozicionin më të rehatshëm në një bisedë, në atë agnostik.

»Shiko«, më bëhet se paskam thënë, por ndoshta edhe vetëm e kam menduar këtë, »nuk mund të them asgjë pa u njohur me objektin; do të më duhej të shikoja planet e ndërtimit, ta vizitoja nga brenda, të mendohesha: e gjitha kjo do të hante disa muaj, porse edhe nëse do i kisha bërë të tëra këto, nuk është e thënë se do të më kishte lindur me patjetër ndonjë ide që do t'ia vlente...«

»Më habit«, shtova pas një heshtjeje, »mënyra se sa shpejt priten drutë këtyre anëve, se sa shpejt e atypëraty parlamenti vendos jo vetëm prishjen, por zgjedh edhe projektin fitues të ngrehinës së radhës. Mirëpo parapëlqimet e mia personale, nëse flasim për objekte të tilla, duhen lënë mënjane e, nëse do të isha shefi i kësaj pune, do të përpiquesha ta shikoja çështjen më me objektivitet, gjë që është, natyrisht, vetëm deri diku e mundur. Një gjë është e sigurt: ky përbindësh nuk ka asnjë vlerë arkitektonike e as ndonjë estetike; nëse ka të tilla i bie të jenë ose të natyrës historike, ose të asaj muzeale. Tani, edhe ai pallati atje me njëzet e ca kate, edhe ai gërmadhë fringo e re është, parë kështu, e po ndërtohet mu tani bash në qendër të Tiranës, pa çka se nuk ka mbaruar akoma, por të paktën nuk ka ngarkesën emocionale të diktaturës, ndonëse ka një tjetër asisoj, atë të kapitalizmit vulgar, të çoroditjes së pafre. Dikur na vrau e preu Enveri, qeveria, shteti; sot të qërojnë vrasës gjaknxehët a gjakftohët, gjakmarrës, tipa me silenciator a me pump-gun, dealer-a droge, apo ndonjë i fortë që nxehtet kot në kokë të vet; dikur na morën në qafë parimet; tani po na merr mungesa e përfarshme e tyre.

Natyrisht që unë nuk jam idiot që të pohoj se tani qenkësh po aq keq sa edhe nën diktaturë, apo edhe më keq akoma: që atëherë ishte më mirë; e tashmja është në njëfarë mënyre vijimësia e së shkuarës e nëse nuk duam të jetë kështu, do të na duhej të ndaheshim përfundimisht prej saj duke e përpunuar, jo duke e zhbërë, thjesht sepse kjo e fundit është e pamundur. Por, më tepër se aq, jam pothuajse i lumtur që aq më bën se ç'ndodh me të, pasi problemi i vërtetë nuk qëndron te ndërtesa, por në mendjet e njerëzve; janë ish-bashkëpunëtorët e Sigurimit, por edhe të përvuajturit e asaj kohe, ne të tërë thuajse, që e kemi vetëdijen e trazuar, vetëdijen e fajit, pasi të tërë e dinë se këtu ka ndodhur një krim. Me një fjalë, piramida e vërtetë gjendet në trutë e gjindjes, ndërsa kjo këtu«, e përsërita vetë tash gjestin e mëparshëm të mikut, duke e treguar me përçmim, »është vetëm një kopje e mjerë e arketipit të botës ideale, sipas Platonit, po të duash.“

“Pra, do e mbaje.», vuri pikat mbi i mikun, të cilit i pata kopjuar gjestin, ndonëse nuk ishte kjo ajo që kisha dashur të thoja.

3.

Kur u ndamë e u largova nëpër zheg i vetëm, tema e bisedës më ndiqte pas si një pulëbardhë vazhdën që lë në ujë anija. E kjo nuk kishte të bënte me ngrehinën në fjalë; nuk ishte ajo që nuk më lëshonte, por simbolika e arketipit piramidat si e tillë.

Në zanatin tim është e zakonshme të përballesh me figurat elementare dydimensionale në letër e më pas me trupin në realitet, me dimensionin e tretë.

Janë tre figura arketipale; trekëndëshi, qarku dhe katrori. Në artet figurative, veçanërisht në arkitekturë, është e këshillueshme të mos përdoren të trija sëbashku, për të shmangur eklektizmin, por e shumta dy të tilla, gjë që shpesh është e detyruar nga tredimensionaliteti dhe kompleksiteti i formave dhe funksioneve. Çdo kombinim tjetër më kompleks është veçse fraktal i këtyre tre elementëve bazikë.

Nëse do të provohej, në një përpjekje të thjeshtëzuar, të rrokeshin kahjet e artit,- e jo vetëm të tij, por edhe i gjithë mundi botëkuptues i feve, filozofive, shkencave, etj.,- këto kahje mund të ndaheshin në mënyrë, e përsëris, fort naive e të thjeshtëzuar, ndoshta vulgare, në dy kampe të mëdha, në dy prirje themeltare.

Njëri kah është ai që merret drejt reduktimit, zbërthimit të gjithçkaje në emëruesin më të vogël të mundshëm, pikës, drejt zeros, atomit të Demokritit, monadave të Laibnicit, monoteizmit mbase; tjetri është ai pagan, pluralitetit të zotave, hinduizmit, bigëzimit aristotelian, multiverseve.

Në epoka të ndryshme e stilet artistike gjendet e njëjta sinusoidë. Ndërsa arkaizmi priret drejt arketipit, epoka klasike mëton të gjejë masën e duhur, më pas vjen baroku, rokokoja, ornamentet e pastaj kurba nis të priret

sërisht drejt thjeshtëzimit.

E tëra kjo përkon edhe me vetëdijen jo vetëm estetike të njerëzimit, por edhe me ngritjet, shkëlqimet dhe rëniet e tij; me lufrat, epokat e arta, shkatërrimet, përmytjet e kështu me radhë.

Ndodh, më shpesh se ç'mendohet, që të dyja prirjet e lartpërmendura të fqinjërojnë pranë e pranë. Nëse piramida është shembëlltyra e përsosur e reduktimit, labirinti është shembëlltyra e përsosur kah harlisja. Në Egjiptin e vjetër, ndërsa piramidat i kanë mbijetuar kohës, labirinti, i cili, sipas Herodotit, tejkalonte çdo përfytyrim, madje edhe piramidat vetë, ka patur fatin e përkundërt.

Arketipet, me sa duket, janë më solide, më stabile, jo vetëm nga ana statike, se fraktalet e tyre. Por ka edhe diçka më elementare se vetë piramida: shkretëtira. Njëren me tjetrën i lidh era, rëra, reduktimi i gurit në emëruesin më të vogël të përbashkët, me hiçin; nëse piramida do të shprishej e do të frynte erë ndërkaq, çka do të mbetej prej saj do të ishte vetëm lëndë shkretëtire, një valle rëre.

4.

Kjo përsiatje m'u ndërmend edhe një herë kur mbarova së lexuari “Piramida” të I. Kadaresë. Ky është ndoshta libri më shtypës, më kompakt, i tij; ka fort dendësi edhe te “Pallati i Ëndrrave”, por ngjashmëria fqinjërore është si ajo e piramidës me labirintin; vetëm dendësia atmosferike dhe lënda e përdorur, lëndë makthesh, të ngjallin asociacionin e fqinjërisë.

Ndërsa për nga stili, për nga intermezzo-t (nga kronika) romani të kujton “Kronikë në gur” dhe “Kështjella”, këtë të fundit edhe më tepër, pasi, nëse te ky sulmohet një kështjellë, te “Piramida” po ngrihet një e tillë, që nuk do mbajë të gjallë të rrethuar brenda, por vetëm një të vdekur të rrethuar prej gurësh. Me një fjalë, rrëfimin e kështjellarit arbër, subjektin njerëzor, vendin e tij, e merr guri, guri i lëvizur me mundime të mëdha sizifiane prej të gjallësh që shpesh shtypen prej tij, bien rrugës nga ngjitja e tij në majë; Sizifi dhe guri ndërrojnë vendet; këto intermezzo janë edhe zemra e romanit e janë të shkruara fort mjeshtërisht.

Ndonëse pesha e gurëve, hetimet, ndëshkimet, përbetimet e denoncimet, krijojnë te lexuesi një kaplim shtypës, me një fill të hollë humorit të zi rrëzëllitës autori ruan drejtpeshimin mes makabritetit e zymtësisë, nga njëra anë, dhe lehtësisë efemere të absurdit, të përsëritjes së historisë deri në mërzi, nga ana tjetër. Ambasadori sumer që i nis raportet sekrete shtetit të tij me qerre plot me pllaka të shkruara argjili; bathët (nënkupto; fasulet, groshët tona) për të cilat njerëzit mbajnë radhë; jeta pas vdekjes e faraonit Snefru, e cila mund të përkthehej edhe si ajo e Enver Hoxhës: një ditë, pastaj edhe një ditë tjetër... pastaj vijnë shokët Gogo Nushi, Hysni Kapo dhe Kadri Hazbiu për një mbledhje të organizatës, edhe një ditë, një tjetër ditë... i japin së tërës një frymë lojcake rrëzëllitëse, që i rri bukur asaj të përzishme, që përshkon tekstin fund e krye.

5.

Po flisja ca më sipër për kohë leximi; nuk ishte e njëjta gjë të lexoje para '90-ës; tjetër gjë është po ashtu të lexosh nga '90-ta e këtej. Leximi në robëri është i ndryshëm nga ai në liri, por edhe ky i fundit varet nga lloji i lirisë në të cilën gjendesh.

E njëjta gjë i ka ndodhur, me sa duket, edhe autorit gjatë shkrimit të këtij romani; ndërsa treçerëku i librit është shtypës, alegorik dhe asociativ, nga kreu i XII (Dhunimi) e deri te ai i XV (Kafkana) stili ndryshon papritur, syri gjithëparës,- siç tregohet ky në teoritë konspirative, ku nuk harrohet të përmendet simboli masonik mbi dollar, por që mund të krahasohej me këndvështrimin e një autori të gjithëdijshëm,- syri gjithëparës pra, piramidioni, si të thuash, i cili deri më atëherë ka qenë panoramik, vjen e fokusohet te personazhet: e gjitha kjo është shkruar fort bukur e mjeshtërisht, porse nuk është në vazhdën e asaj që e ka paraprirë. E njëjta gjë ndodh edhe me paralelen e hequr me Timur Lengun dhe spagatën me bunkerët e Shqipërisë; faqja e fundit, për shijen e shkruarit të këtyre radhëve, është mëse e tepërt.

Pjesa me Timurin e çalë është e shkruar dhe ajo fort mjeshtërisht e do të kërkonte një shkrim më vete, mirëpo filli që e mban lidhur me rruazat që i kanë paraprirë është i hollë dhe i kërkuar, metafora si e tillë, simbolika e saj, mund të gjendej në gjithë piramidat e kësaj bote, qysh nga majat e Amerikës Jugore e deri në Kinë e Indonezi.

Shkruesi i këtyre radhëve është vetëm lexues e ka fort të ngjarë të gabohet; sidoqoftë ai mendon se pjesa "Kafkana" duhej të ishte nxjerrë diku më vete, si novelë më vete; por është e kotë të supozojmë për fatin e saj, pasi ajo

është tashmë e përfshirë në roman e ky i fundit është fakt i kryer; mund t'i sugjerohej lexuesit, pasi të kish mbërritur te kreu i XII-të, ta linte librin për ca kohë mënjane, të lexonte diçka tjetër në mes, pastaj të vazhdonte deri te kreu i XV-të e të bënte të njëjtën gjë edhe me pjesën e mbetur.

Me sa duket, edhe për autorët vlen thënia e vjetër e Heraklitit: “Askush nuk zbret në të njëjtin lumë dy herë njëlloj” e romani nuk është shkruar në vijimësi, por në gjendje të ndryshme krijuese, ndoshta edhe lirie.

Mirëpo, ashtu siç ka një kohë leximi, një të tashme të tij, po ashtu ka edhe lexime të shkuara, një kohë pasleximi, e kur lexoj se ç'paskam shkruar më sipër në një kohë të tillë pasleximi, mendoj se ndoshta ajo që shkrova për fillin që i lidh pjesët me njëra-tjetrën kishte kuptim përgjatë leximit, por jo më tani, për pasleximin, ashtu si shija e disa ushqimeve të zgjedhura të vjen ca me vonesë, pasi i ke përtypur ato.

Ndaj, tani, në një kohë të dytë, kur sjell ndërmend dy imazhet bazë të kësaj novele, piramidën prej guri të Keopsit e atë me kafka të Timur Lengut, më duket papritur se tash ata rrinë për bukuri përbri njëri-tjetrit.

Çka e lidh piramidën me labirintin, shartimi i tyre, si të thuash, i reduktimit maksimal me mëtimin e pafundësisë është po ashtu stuhia e rërës, labirinti i shkretëtirës, diçka amorfe, kaotike, e pështjelluar, e panënshtueshme dot, diçka si era, po, turma, thashethemnaja, piramida e shpirttrave, e ëndrrave, piramida prej rëre.

E kjo është edhe lënda e vërtetë e këtij romani.

6.

Pas piramidave të Gizesë, shumëkujt do t'i vinte ndër mend, nëse do të përmendej kjo fjalë, një e tillë moderne prej qelqi në hyrje të muzeut të Luvrit. Pakkush, besoj, e ka patur mendjen, pas gjithë asaj mësymjeje kulturore që pëson vizitori në muze, kur ka dalë prej andej e ka marrë ndoshta përposh për në metro, që të ngrejë kryet e të shohë një piramidë xhuxhe të varur në nënkallim, një kundërpiramidë, nëse nuk më gënjen kujtesa. Ndoshta gjithçka ka nevojë për të kundërtën e vet, pasqyrimin e vetvetes, ku të mund të kundrohet, ku do të mundte të plotësonte me tjetrën gjysmën e gjymtë. Strukturat njerëzore, në të gjitha kohërat, edhe në ato demokratike, kanë qenë hierarkike, piramidale. Ndoshta, ndonëse kjo është utopike, do të na duhej të mëtonim ca më shumë për të tjera forma po aq të përsosura, në të cilat pikat janë të barazlanguara nga qendra, struktura rrethore pra, në mos sferike. Mirëpo në paragrafin e mësipërm ka një të panjohur të madhe: ne, njeriu. Fort është përpjekur të ndryshohet ai, të gjykohej, të ndahet gruri nga egjra, fort është keqkuptuar ai, prej kujt? Prej atij vetë.

Kafkat tona janë gurët me të cilët kemi ndërtuar piramidat tona, shpesh fort të pjerrëta.

7.

Idetë e dy miqve të mi nuk po më ngajnë, tani që hodha këto radhë, aq të këqija; më mirë akoma, mendoj, do të kishte qenë një kombinim i tyre.

Pasi t'i hiqnim rropullitë mumies, piramidës së Enver Hoxhës, e t'i linim vetëm skeletin prej betonarmeje, mund ta mbushnim kafazin, burgun e krijuar, me kafka, me kafka porcelani ndoshta, ashtu si Ai Weiwei pat mbushur dikur një sallë ekspozite me fara luledielli porcelani. Numri i kafkave mund të llogaritej lehtë.

Ndërsa në majë, aty ku dikur gjendej ylli pesëcepësh, mund të vihej mbikafka, kafka e ndonjë koke të madhe, më të marrit të anëve tona, e cila, nëse pushteti është marrëzia më absolute e ka shumë të ngjarë të jetë ashtu, do i binte të ishte e kujt?...

Por kjo është vetëm një ide e marrë hua nga libri e ndaj le ta lemë më mirë mjeshttrin të flasë vetë:

(...) Duke qeshur e duke u tallur kërkuan ndonjë kokë të stërmadhe, por meqë nuk e gjetën aq sa ç'e kërkonin, dikush u kujtua për Mongkën, një torollak kokëmadh, nga ata që ndiqnin pas karvanët ushtarakë. E thirrën budallanë, i thanë: »do të bëjmë princ« dhe, pasi ia prenë kryet nën gazmendin e të gjithëve, i derdhën plumb të shkrirë sipër çackës dhe ia vendosën në majë. (...)



VEÇ ME U ÇMEND!....

ese nga
**REXHEP
FERRI**

1.

Mos mendoni se do të bëhet mirë.
E ardhmja është me plot të panjohura.
Duke hipur shkallëve të Piramidës, një thirrje më vjen si pyetje.
Si do të duket bota në të ardhmen?
Nga lakmia dhe luksi deri te kënaqësia e paprovuar.
Në pikë të ditës, në krizë morali, në krizë shpirtërore, njeriu shikon njeriun si eksperiment.
Qetësohet kur dhembje a kokës i pushon.
E thashë, por pse e thashë nuk e di.
Mali ka vesh.
Njeriu ka durimin.
Për të maskuar frikën bëhet i fortë.
Guri, si guri!
Po të mos ishte i fortë guri si guri, çka do të bëhej në malet tona.
Ku do të shkonim?
Ku do të humbisnim?
Në shërbim të kujt do të jemi?
Të Zotit për Zotin.
Të njeriut për njeriun.
Të djallit për djalin
Ora kalon e nuk vonohet.

2.

Këtë dhuratë e kemi nga koha që na ka ikur.
Nga koha që nuk e kemi njohur.
Koha që do ta harrojmë.
Si mendoni?
Erdhi çka erdhi!
U bë çka u bë!
Çdo gjë për çdo gjë.

Për gjakun e egër.
Për gjakun e zbutur do ta humbim fuqinë.
A ka mbetur edhe diçka tjetër pa u thënë?
Me patriotët mashtrues nuk po dua as ta parashikoj fatin.
Çdo ditë shoh gjëra më shumë se të turpshme.
Edhe po, edhe jo, vetes i thashë.
Në këtë botë të madhe dhjetë herë në ditë veten e kërkojmë në pasqyrë dhe nuk shohim asgjë.
Përtej kësaj historie nuk ka shënime për kohën.
Njeriu duke u ngritur mbi mashtrimet e veta e rrezikon personalitetin.
Fama për mbretërinë e sundimit e mundon.
Për idenë e fundit mos më pyetni pse.
Të gjithë ata që nuk e dinë se çka është lufta, ikin nga lufta dhe me famën e rrejshme e shpallin veten patriot.
Ç'dreqin po bëhet nuk e di!
Kuptimin e luftës ta lëmë me kaq.

3.

Në këtë botë të madhe e të rrejshme, jetën e kemi menduar si mit.
S'desha të flas për mite, por prapë fillova të marr frymë e të jetoj.
Me mite e kam një histori të gjatë.
Nga realiteti në realitet, liria kurrë s'ka pasur më pak respekt.
Kërkush nuk e di se kush është kush.
Kur jeta nuk të kthen përgjigje, gjithçka është e mundur.
Të gjithë flasin kot.
Për të thënë të vërtetën s'ka rëndësi sa kushton realiteti.
Gabimet për njeriun janë natë, mesnatë.
Nga optimizmi tragjik as unë nuk pashë asgjë.
Në kohë të liga çdo gjë vjen me ditën e vet, kohën e vet, turpin e vet...
Pse jemi kaq të pabesë kurrë s'e kam menduar!
Mbi peshën e tokës, për rrugaçërinë e ditëve tona gjithçka është e mundur.
Le të fabrikohen mashtrimet.
Ngjarjet po shiten.
Lehtë e kapën tregun.
Për anatominë e një morali, për popullin e lashtë e të ri, ende, si gjithmonë, s'kemi dorë fati.
Krenaria dhe lufta.
Krenaria dhe humbja
Për ta harruar luftën pas shumë përgjigjeve vetëm kaq.
Nuk është e vërtetë se kemi shumë heronj.
Famën e tyre ende e kemi vetëm në këngë popullore.
Në stilin e patriotëve të viteve që ikin, nuk na mjafton as krenaria e as lufta.
Nga përrallat patriotike na është helmuar gjaku deri në atë masë sa nuk mund ta durojë as lëkura e gjarprit...

4.

Për një kohë të dhunshme e të pashpjegueshme, prezantimi bëhet pa dëshmitarë.
Historia e panjohur ka mbetur aty ku e ka lënë koha.
Në tokën e varreve.
Në rrafshin e ndërgjegjes së humbur.
Sot është ditë zie.
Zbritja e flamurit në gjysmëshitëzë na flet për jetën që e kemi dashur. Për jetën që e kemi harruar...
Më 1997 kur te Kodrat e Tiranës plasi lufta qytetare, nga ajo ditë i humba të gjitha shpresat.
I ruajta vetëm ato që i kisha vizatuar gjatë kohës kur isha student.
Ky realitet, si realitet, nuk flet as për luftën e as për lirinë, as për kombin e as për shtetin.
“Çfarë ndodh kur njerëzit humbin një apo më shumë pjesë të trupit?”
Si përgjigje, apo si pyetje çdo njeri e ka plagën e vet.
Ekspozita me shtatoren e heroit të panjohur po flitet se po hapet nesër.
Atëherë kur mes nesh jeta bie në gjunjë, nata ditës i thotë mos u frikëso.
Këtë fotografi në Shkodër nëna e ruante.
Me kuptimin e impresionistëve shpesh ma tregonte.
Pas vdekjes së nënës, atë fotografi ma kërkonte motra.

Gjithmonë, më fal, i thosha.
Në atë fotografi jam unë me nënën.
Tani s'kemi as çka të mendojmë.

5.

Nuk ka më pyetje.
Çdo gjë e kam të lexuar.
Aty ku takoheshim po shkoj.
Ku unë isha unë...
Dervishi që flinte nën Urën e Vezirit më pyeti:
- Trim, prit pak, më falni, kush jeni?
Para se të harroj, po u them diçka: Për veten e të tjerët ta lëmë me kaq, i thashë.
Për ta rishikuar fillimin ma jepni adresën!
Takohemi!
Flasim!
Te kufijtë e lindjes, për diçka më shumë.
Mes hiçit dhe asaj që vazhdon të përsëritet sa vlen të besojmë?
Sa vlen të pyesim: Ku po shkojmë?
Mos u lodhni kot.
Njerëzve u ka humbur kuptimi i jetës.
A jemi në rregull, syri i majtë e pyeti syrin e djathtë.
Çka ka mbetur as unë nuk e di.
Fundi të gjithëve na befason.
Jetën kurrë nuk e kam llogaritur si eksperiment.
Njeriun e shpellave parahistorike shpesh më vjen ta pyes:
- Çka është gjuetia?
- Ende nuk po e kuptoj pse gjithë kjo rrëmujë, - më tha. – Shikoni atje poshtë, kur mjegulla bie mbi mjegull, jeta lexohet ashtu si shkruhet. Nga e djathta në të majtë, nga e majta në të djathtë. Duhet ta kuptoni: Unë nuk i besoj askujt!...

6.

Jemi në shekullin e vrasjeve shpirtërore.
Problemet harrohen.
“I lirë është njeri që bota e pyet dhe që i përgjigjet botës”.
Katër, tre, dy, një...
Çka ka mbetur nuk e di.
Jeta nuk është tallje.
Pas luftës, çdokush flet për lirinë.
Për lirinë që e kemi njohur pa e parë.
Që kemi dashur pa e ditur sa kushton.
Si na erdhi që e shitëm.
Kush e bleu fitoi.
Kush e shiti humbi.
Provoni një matematikë tjetër.
Krahasimi me ne nuk na bën nderë.
Nëse më kini mik, harrojeni këtë që u thashë.
Nuk flitet më për krijimin e botës.
Nuk po them se është çuar mjegulla.
Cili është qëllimi nuk e di.
Dallimi është si nata me ditën.
Për gjithçka dhe asgjë jo dhe jo.
Ku na mbeti dhe ku na humbi besimi për njeriun.
Përsëri një intrigë diplomatike.
Sa për sy e faqe dikush tha:
- Kujt po ia ndien!
Vetëm koha në dialog e çeli gojën.
Dhe jo vetëm kaq.
Për tragjedinë e famës së rrejshme të njeriut vazhdon komedia.
- Po cila komedi? – Korbi i Zi e pyeti Korbin e Bardhë.
Komedia e historisë së sojlinjve tanë për interesa personale, njeriut pa atdhe e vret me një plumb qorr.

7.

Me Pëllumbin e Pikasos, me Pëllumbin e Lirisë, na iku edhe koha e tashme historike.
Kush mendon ndryshe në vend të syve i ka dy shpella të zeza.
Kur era fryn e fryn, me famën e vet, vjen një kohë dhe shkon një kohë.
Ndryshe nuk mund ta kuptojmë as të keqen e as të mirën.
Sa larg do të shkojmë nuk e di.
Sot çdo rrugë është si një ëndërr mashtruese.
S'kemi se çka të mendojmë më shumë.
Kemi një patriotizëm të mbivlerësuar dhe të korruptuar.

Nuk do di s'i t'i bie në fije.
Për ta mashtruar vetveten kemi më shumë kohë se hapësirë.
Guri kilometrik i rrugës kërkon përgjigje.
Nga fundi i hidhur na vjen ulërima:
“Me një nofull në qiell, me tjetrën në tokë!”
Aty afër, shihet edhe hija e zgjatur e Kalit të Trojës nga një dritare e vdekur.
Nga një përditshmëri e panjohur.
Çdo gjë e gjetur, qoftë edhe e humbur.
Pas krrokamës së korbave kërkush nuk pyet, kërkush nuk përgjigjet.
Për ta mashtruar veten kemi më shumë kohë se hapësirë.
Xhungla urbane të njëjtën gjë e mendon.
Për moralin e njeriut çka mund të bëhet sot?!
Po flitet për një paturpësi të panjohur.
Po kush po flet?
Po kush po premton?
Po kush po vjedh?
Për të shtyrë diçka përpara, nesër është nesër.
Në fund të botës, sa e pabesueshme është kjo botë.

8.

Sot rrugaçëria është art, stil, jetë...
Lehtë për ta kuptuar.
Gjithçka shkurt.
Ta lëmë me kaq.
Mos mendoni dy herë.
Nga kazani i plehrave, koha me kohën e vet, njeriu me vetminë e vet. Kafshët tona nuk besojnë...
Fantazmat e pasluftës, pas mashtrimeve vrapojnë.
Përballë botës, rrugaçëria vetë shkruan e vetë vulos.
Populli jeton ashtu siç e meriton.
I mjafton të krahasohet me vetveten.
O Zot si do t'ia bëjmë?
Shikojeni një herë, kjo botë e mbushur me krime e kujt është?
Për ta ruajtur egon njeriu nuk ka përgjigje.
Edhe kjo pyetje kërkon dëshmirar.
Sot është gabim të besosh.
Patriotët mashtrues të gjitha problemet shpejt do t'i harrojmë.
Kjo mjegull nuk e di se kujt po i shërben.
Duhet ta kishim ditur.
Jetë kote.
Për të çmendurit, kënaqësi.

9.

Në një pikturë tjetër impresioniste, jetës i thonë edhe jetë, edhe vdekje.
Besim i fortë.
Një njeri, nga populli pyeti:
- Kur do të zbresim në tokë?
- Nëse të ka humbur mendja, shko në hënë, - i thashë.
- Dhe pyete hënëën pse është shkëputur nga toka.
- Vetëm nuk shkoj?!
- Po kend po e pret? – e pyeta.
- Njeriun dhe çmendurinë e dashur, - më tha.
Si me një orkestër tjetër.
Si me një këngë tjetër.
Njeriun e kam parë duke ardhur.
Duke u rritur.
Duke u burgosur.
Duke e vrarë.
Të kisha lindur edhe një herë, jo për një jetë të dytë, por për ta parë njeriun se ku i ka varur ëndrrat.
Fjala njeri në fjalorin e gjuhës sime nuk e ka ndryshuar mendimin.
As unë nuk kam pse ta ndryshoj.
Për asnjë çmim.
Sa herë është thënë se njeriu i ka dy mundësi.
Një për ta ditur se çka kërkon kur dikush e thërret.
Dhe, dy, ta dijë se ku duhet të shkojë dhe ku duhet të ndalet.
Kjo që e thashë, nuk doja ta them.
Por në mënyrë të pashpjegueshme: kush do të kullotë nesër.
Si të pajtohem?
Veç me u çmend?!...

Prill, 2020

DRITËHIJA
poezi nga
DASHAMIR
MALO

BUZË LIMANIT TË SHPRESËS

Ndërsa agimi i purpurt ia beh në qytet
dhe peshkatarët kthehen prorre në liman,
në tavernën “Poseidon” fillikat jam ulur
dhe përsëris me vete vargun naimian.

Sakaq njëri syresh vjen e më afrohet,
një kapiten i zoti, i njohur në këtë qytet,
më thotë: Ç'bëre ti për këtë dhé? Asgjë, o mik!
Pale pastaj, i thua vetes edhe poet!

Pse vjen kështu e druajtur, e nemitur
kjo e sotme në vendin tënd, në vendin tim?
A do të jetë e nesërmja aq e ndritur,
siç i këndoi me mall rilindësi Naim?

Buzë këtij deti të trazuar,
ç'përgjigje t'i kthej kapitenit riosh?
Ndodhka të jesh poet mbushur plot me shpresë,
dhe përsëri në këtë vend të ndihesh bosh!

Kupën e së sotmes e kthej me fund
te ky liman ku ish Naimi doganier,
këtu ku i dha udhë vjershërimit shqip,
dhe si qiri mandej për mëmëdhe u ter.

Brigjeve të Kaonisë i nis motivet,
si grigjë kuajsh ranishtes me revan,
nxitoj të bëj çka mundem si poet,
teksa më prin udhën ylli naimian.



FAR

Kur furi e jetes vrullshëm më përplas
detit plot me dallgë e shi kahmos
falë dritës tënde krejt bujare
shpresa dhe vullneti nuk mu sos

Dhe kur ajo trumë gaz që pata pari
davaritet çastit si të ish një re
shpresëthyer me vështrim drejt teje
ia dal mbanë të shkel në stere

Terratisen ditët e trazuara
mbi trazimin ti qëndron mitiku far
që të mos humb fillin prapë labirintit
veç me ty përmallshëm jap e marr

Vetëm zogjtë krenarë
e japin frymën e fundit
në lartësi.

Të kaltra janë ikjet
e tyre,
të kaltra.

Kumbull vetmitare ne mes të
ugarit.
Pranvera të paska veshur me fustanin
e bardhë!
Po ku janë dasmorët?!
Po krushqit ku do të kenë mbetur
vallë?!

Qeti e kaltër në gri,
Mesditë e prushtë korriku,
Ajo që pritej nuk erdhi,
Ajo që ish, tashmë iku.

Ishim dy brigje
që i lidhte deti
tani na lidh tek-tuk
ndonjë zog
shtegtar.

KËNGA
E FUNDIT
poezi nga
ARDITA JATRU

PSYCHE

Lahu zemër
lahu
me ujë perëndie
se fati do të ndrijë,
në mos nuk është’ nisur,
një ditë tek ty do të mbërrijë.

Dhe ajo
mbledh shiun në një kovë
ulet në prag
dhe prët
me durim sa të mbushet.
Pastaj merr kovën
hedh brënda pak hi
nga zjarri i mbrëmjes
dhe nis e lahet.
Dhe shkrihet uji i perëndisë
i rënë nga qielli
flokëve të mëndafshtë
zbret lugjeve
shpërndahet krahëve
dhe bie furishëm si ujvarë.
Në fyejt e saj të njoma,
ndal frymën

pikë
pikë
pikë
fati
tek këmbët

dhe poreve të tokës zhduket
e niset sërish për në qiell
të bëhet uj’ perëndie
ta mbledh ajo në kovë
e të lahet.

Lodron fati me të,
ajo nuk di.



LEGJENDA E SAFOS

Ku është Faon që s’duket gjëkundi mbi det?
Mos varka të kthehet nuk i bindet?
A ndoshta puthet me Aferditën në ndonjë breg?
Oh, Faon!
Safo të pret, buzë greminës tek fari
dhe më digjen mollëzat e gishtave mbi harpë
dhe zëri më meket nga këngët e mallit
për zjarrin që më ndeze shpirtit të etur
ti rinoshi im, i bukuri peshkatar!

U ngrit dielli në majë të qiellit krenar
dhe deti vezullonte si perlë
fluturojnë rreth shkëmbit ca ëngjëj me krahë
në majë pret Safo si hënë e zbehtë
Lefkadhën sheh, Itakën , Kefalonian
dhe një çast bëhet dielli prush mbi det,
në rrëzë të shkëmbit me britma vijnë ca dallgë
dhe shfaqet tutje horizontit një pikë e zezë
në mes të vijës, që zmadhohet e rritet
dhe ngrihen zogjtë nga degët për në qiell
ca klithma pulëbardhash,
të trembura shkundin krahët
ndalon këngën Safo
dhe me sytë e padurimit prek pikën që vjen e rritet
e një tufë me flutura i shpërthejnë nga gjoksi,
kreh flokët me gishtat e gjakta,
shkund cepin e ngritur të fustanit të bardhë,
kafshon buzën dhe bëhet gati për çastin,
kur t’i shfaqet Faon peshkatari përballë.
Rrëmben harpën nga toka dhe këngën nis:

Faoni im i bukuri peshkatar!
Ktheu sa më parë në gjoksin e gruas që digjet.
Na vraftë Erosi të dyve me një shigjetë
dhe perënditë e Olimpiti na bëfshin një varr.
Kthehu e bëhu pika e mbylljes në varg!

Dhe buza i bëhet gjak nga padurimi
dhe gjaku i piket në gushë mbi fustan
kur pandeh që pika e zezë horizontit
ish’ Itaka, që nga erërat, në qiellin e kthjellët u shfaq.
Gjëkundi s’duket varka.

Faon ku je, oiiiiii dashuri,
majë shkëmbit u thava një stinë nën far.
Me vargje lirike vrava pritjen
dhe telat m’u këputën mbi harpë.
Faon, ku je o dritë,
jam grua e mbytur në mall.
Më shkrumboi dielli
më lëkundën erërat,
më gjunjëzoi nata,
qielli më rëndon mbi krye si pllakë,
u verbova tashmë,
nga kripa e dallgëve sytë m’u thanë.

Faon, o peshkatar,
kjo, është e fundit fjalë,
u bëftë pritja ime lule e egër mbi shkëmb
e trupin tim e përpiftë kjo dallgë që vjen furishëm.
Refuzimi yt legjendë u bëftë.
Po shkoj në Hades, përfundimisht
të endem me shpirtrat mëkatar.
Lamtumirë o fitimtar!

Dhe Safo lëshoi harpën në tokë
zbathi këmbët mbi barin e vestë
çliroi trupin nga fustani i hollë
dhe e hodhi vrik në humnerë.

Lamtumirë o far!
Lamtumirë o peshkatar!

PREZANTIM I DETYRUESHËM PËR
KOPERTINËN PAS LIBRIT

Jam dyzet e tetë vjeç.
Jam e lumtur
Përderisa kam një familje.
Kam bërë pakt me subkoshiencën.
Shkruaj poezi të singerta.
Tani e di,
e re paskam qënë e bukur
por me mungesë vetëbesimi.
Të paktën të ma thoshte nëna.

Jam shumë e ndjeshme.
Spontaniteti im shpesh keqkuptohet.
E vogël kisha një ëndërr.
Tani e kam harruar fare.

Jetoj tridhjetë vjet në Greqi.
Shoqja ime e ngushtë është Elpida.
Nuk kam votuar kurrë.
Ushqej macet e lagjes.
Kemi ndarë zonat me zonjën Violeta.
Dikush duhet ta bëj.

Jam dyzet e tetë vjeç.
Nuk kam formim akademik.
Vuaj nga fobia sociale.
Më ndjek origjina ime.
Marr përgjegjësitë e të tjerëve mbi shpatulla.
Në fund të ditës
bie në gjumë e vdekur.

Jam me fat
që kam një burrë të mirë
e s’ka tentuar ndonjëherë të më vras.



KËNGA E FUNDIT

Ana,
kujdesu për mua
krihmi flokët me gishtërinjtë e hollë
se për ty kam krijuar një himn.
Eja, lamë për të fundit herë
dhe e dashur, falmë,
siç ti fal shiun kur gjethet rrëzon në tokë, padashur.
Në sirtar është një fletore pentagrami,
hape në faqen e fundit dhe këndoje pa zë.
Pranoje si dhuratë,
pastaj thuamë, nëse i mungon diçka
që të jetë e përsosur.

Ana,
një mollë pret për ta qëruar. Qëroje ti!
Në vazo, lulja është etur për pak ujë. Ujite ti!
Shallin e bardhë, dy dimra pa u veshur, vishe ti!
Dhe tani, hape dritaren e dashur,
të shijoj melodinë e pyllit teksa zhvishet këtë stinë.
Oh, në kokën time ka veç heshtje.
E ndien dridhjen e ajrit?
Është fryma e Zotit.
Fytyra jote, shëmbëlltyra e Tij!
Kam qenë i humbur pa ty, Ana,
hutaq si një i verbër,
mjeran si një i shurdhër.
Ana,
qeni po angullin,
paralajmëron shtegtimin e shpirtit.
Po ç’ka përtej pyllit, Ana...?

LINDA

tregim nga

Liridon Mulaj

- Rrua e qumështit është çatia e udhëtimeve tona, - më tha dhe u ngrit me vrull duke hedhur përreth kokrrizat e vogla të rërës. Hoqi fundin e verdhë me pala nga ku poshtë tij zbuloi vithet e rrumbullakta në ngjyrë bronxi, nxirë nga dielli i lëbyrët i Qershorit dhe u nis drejt detit duke hequr reçipetat të cilat i hodhi në prag ku bashkohet toka me ujin, bash aty ku dallgët lëpijnë buzët e ngurta të bregut. E vështroja Lindë n që zhytej ngadalë në ujë, nga ku herë pas here kthente kokën nga unë, dhe me sytë e saj të zjarrtë si dy yje të shkëputura nga qielli më vështronte me një shikim ndjellës. Lëvizte krahët lart e poshtë dhe më thërriste t'i bashkohesha, pa pyetur për shtangien time dhe ndiesitë e mia të turbullta kundrejt saj. Ishte natë e freskët, nga ato netë ku ende stinët nuk janë ndarë nga njëra tjetra dhe era e ngrohtë e verës mbështillet me freskinë e pranverës dhe bashkë, gënjejnë lëkurën që herë shtriqet e hap poret e saj e herë mbushet me morrnica. Nuk arrija ta kuptoja në fakt nëse shkaku i morrnicaeve ishte vetëm era e freskët apo diçka tjetër. Linda lahej në detin e errët të natës, dhe unë herë pas herë i buzëqeshja asaj, gjithmonë duke nënkuptuar se në atë largësi, ajo do e shquante mimikën time.


E kisha njohur prej pothuajse pesë vitesh Lindën, në një galeri arti ku të rinj nga fusha të ndryshme të artit mblidheshin dhe lexonin poezi nën dritat e ethshme të një projektori të vjetër. Atë natë që takova Lindën, nuk e mbaj mend se çfarë i thashë përveçse një lëmshi fjalësh të pashpjegueshme në formë komplimenti dhe përgjigjen e saj pothuajse identike me lëmshin tim. Të dehur, ne qeshëm njësoj dhe pas disa bisedave shkel e shko me belbëzime dhe klithma kënaqësie e gjetëm veten të shembur në një kolltuk me krahë prej druri dhe të përqafuar si dy dashnorë të moçëm. Linda ishte e gjatë, e imët me flokë te verdha si të lyera me një lloj lëngu shkëlqyes. Dhe në tërë shtatin e saj, këmbët kishte pikën më të fortë. Fliste pak me droje por kjo mënyrë të foluri nuk ishte aspak një drojë e zakonshme prej një femre që kishte turp, por të flisje pak dhe me zë të ulët për Lindën ishte si të haje pa u mbllaçitur apo të urinoje brenda vrimës së bidesë pa lagur anash pllakat, pra ishte

pjesa themelore e sjelljes së saj të cilën ajo e quante herë pas here etikë e domosdoshme e qenies njerëzore. Dhe ajo drojë kaq origjinale i jepte portretit saj prej bronxi të larë në shkëlqim, një pamje fisnike. Të ngjallte respekt teksa filste dhe më vështronte në sy dhe për çdo fjalë apo temë fare pa rëndësi ajo përtypej dhe nën gushë i shquhej një si një dallgë e fshehur që lundronte brenda gurmazit. Fliste ngadalë deri sa lodhej dhe më pas, mes gishtash mbërthente gotën e konjakut dhe e pinte me epsh burrëror. Mandej rehatohej, ndizte cigaren dhe m'i ngulte sytë e zjarrtë si egërsirë, këmbët e gjata i hidhte njëra mbi tjetrën, largonte paksa baluket si fije ari dhe teksa të gjitha këto i aktivizonte si pjesët e një ingranazhi, ia riniste bisedës me po atë qetësi dhe drojë të beftë, të sajën, vetëm të sajën. Nuk e doja ose më saktë nuk e dashuroja Lindën ose saktë fare e doja shumë por jo siç mund të duhet një femër e zakonshme. Në të vërtetë nuk ka femër të zakonshme pasi të gjitha janë të jashtëzakonshme por Linda, përtej kësaj ishte një krijesë krejt e rrallë. Ose së paku kështu e shikoja unë. Ne kishim udhëtuar kaq herë bashkë. Në male, dete, me çadrën e kampingun mbi shpinë dhe me çantat tona të rrobave. Linda përherë merrte me vete dy bluza, ndërkohë unë merrja tre dhe sapo rehatoheshim në vendet tona të fushimit, ajo rrëmonte brenda çantës sime, dhe merrte një nga trikot e mija për ta veshur. E çuditshme vërtetë por unë përherë merrja një rrobë më shumë se ajo dhe ajo gjithmonë përfundonte duke veshur rrobën time, si në një marrëveshje të fshehtë, të pazakontë. Pra kjo ishte ajo çka e bënte Lindën mbi-femërore si një qenie metafizike ku mes saj dhe meje ekzistonte vetëm një lidhje e largët transhendentale përmes një filli të padukshëm që rrinte gjithnjë i tendosur dhe ruante saktësisht mes nesh distancën e nevojshme që shndërronte Lindën në një muzë, dhe mua në një jo-dashnor. Ishte ky fill i padukshëm që ngërthente në të si pas një trangu këtë lojë veprimesh të koordinuara saktësisht nga telepatia jonë, nga një parandjenjë e kthyer në zakon apo si një bashkëveprim i mirëkordinuar jo nga ne të dy, jo teknikisht por nga forca e mbinatyrshme e cila qëndronte pezull dhe e padukshme mbi Lindën dhe që efekti i saj mbërrinte der tek unë. Ajo forcë që nuk donte t'ia dinte për joshjet, për lidhjet dhe dashuritë e rralla dhe të lodhshme. Që më kthente mua në një krijesë mizore dhe stoike, që s'pyeste për lëkurën e saj të bronxtë, këmbët e gjata e të lëmuara dhe se përtej të qenit joshëse e egër dhe krejtësisht e rrallë, ajo ishte muza e përjetshme e lidhur me shpirtin dhe ekzistencën time dhe jo me epshet e mija të rëndomta. Ajo po kridhej në detin e errët dhe hera herës kthehej dhe më thërriste t'i bashkohesha asaj duke përplasur duart mbi kokë. Nata ishte e thellë, me ca yje të zbehura tej e tej dhe vetëm në mesin e qiellit mbi kokën time, udha e qumështit ndrinte si një autostradë ajrore mbushur me automjete të cilat qëndronin në vënd. Toka më ngjante e kthyer së prapthi dhe mendoja se ishim ne që vështroim qiellin nga lart, si në një përmbysje të imagjinuar. Dhe vërtetë Linda nuk gënjente. Në të gjitha udhëtimet tona pothuajse, qielli kishte qënë i kthjellët dhe udha e qumështit e mbërthyer në qendër të tij si një harnë gjigande, ia shtonte hijeshinë atij qielli të zymtë. Edhe atë natë kur me Lindën përfunduam

duke fjetur në stolat e lulishtes para shtëpisë muze të një shkrimtari të madh. Ishte dita e ekspozitës sime. Kisha këmbëngulur prej kohësh që ekspozita të mos mbahej në Galerinë e Arteve siç ndodhte rëndom por në një ambient më të ngrohtë dhe paksa kontemporan dhe në fund ramë dakord me kuratorin tim që ta mbanim në një shtëpi të vjetër dy katëshe të pabanuar prej kohësh. Po vishesha në studion time. Kur po tentoja të lidhja kravatën, hyri Linda. Në dorë mbante një shishe verë të kuqe. Flokët e kapura bisht i jepnin një pamje prej çupeline, pamje të cilën e përforconte herë pas here me çamçakizin që e frynte dhe e plaste duke shkaktuar një poterë aspak të këndshme. Më puthi në faqe dhe pasi u hodh në kolltuk si e rënë nga qielli, më tha se kishte ardhur të festonte me mua ekspozitën e parë. I thashë që s'kishte asnjë shans sepse për pak në vendin ku do mbahej ekspozita do ia behnin ministri i kulturës dhe drejtori i Galerisë, por ajo duke më parë vengër, shtrembëroi paksa buzët dhe pasi hoqi shikimin nga unë duke e ngulur në parketin e ngjyrosur me pikla boje, ia plasi të qarës si fëmijë. Më kot u mundova ta qetësoj. E mora pranë vetes dhe e mbërtheva fort siç mbërthen një ushtar në luftë mikun e tij të plagosur dhe pasi ndenjëm ashtu për disa minuta, ajo u tërhoq mënjane dhe duke fshirë lotët, me një zë të përvajshëm më kërkoi t'i bëja një pikturë nudo, ashtu dhe aty ku ishte, në atë kolltuk të pistë dhe të shpëlare nga dielli i kushedi sa viteve që derdhej në studio nga dritaret e mëdha të tavanit. Linda u ngrit dhe me lëvizje të shkathëta prej maceje, hoqi rrobat duke zbuluar para meje gjinjtë e saj me majë në formë dardhe. Hoqi mbathjet dhe me një dorë mbuloi pubisin ndërkohë me tjetrën përdridhte ca fije flokësh të bëra shtëllungë anë faqes. Zuri vend në kolltuk në një pozicion si e vdekur, duke zbuluar para meje gjithë trupin e saj të mrekullueshëm. Pikturova tërë pasditen ndërkohë të dy pinim verën e kuqe që kishte sjellë me vete nën tingujt cingërues të ziles së telefonit që binte pa ndërprerë. Në djall ekspozita thashë me vete. Linda është muza ime dhe vetëm në sajë të Lindës unë mund të pikturoj sërish, dhe në të vërtetë ajo ishte ekspozita dhe piktura ime më e shtrenjtë e cila nuk mbërthehej në asnjë telajo dhe kornizë. Ishte shpirti i gjallë i artit të cilin kërkoja të zbuloja dhe të aplikoja pa reshtur përgjatë gjithë jetës sime. Vetëm unë dhe qenia e saj, të veçuar nga bota. Të dehur në atë marrëdhënie aq sublime dhe të paqartë. Të mbetur përjetësisht peng të njëri tjetrit, pa njëri tjetrin plotësisht. Ajo më shërbente mua dhe muzës sime ndërkohë unë, isha rishtar i shpirtit të saj të cilin ditë pas dite, si në një jetë që rifillonte çdo ditë nga e para, rrekeshja ta zbuloja dhe ta dashuroja pa e përvetësuar, pa e lënduar. Të dy si Lysieni dhe Esteri të Balzakut të cilët krejt pa dëshirë zgjodhën të mos ishin bashkë po dhe të mos ndaheshin kurrë, duke i shërbyer dashurisë dhe asaj ndjenje të zjarrtë që i tundonte e njëkohësisht i ndante. Pimë shishen e verës dhe pas saj një gjysëm shishe raki të mbetur prej kohësh në raftin e studios. Qeshëm atë ditë si të marrë, me atë që bë më, me mesazhet dhe sharjet që pareshtur e tërbonin telefonin tim. Qeshëm me lotët e saj dhe me gjithçka atje përjashtë që kërkonte të gjymtonte qenien dhe ta shkatërronte pa reshtur magjinë që krijonte filli i padukshëm mes një muze si Linda dhe një piktori si unë. Në djall ekspozita, dhe drejtori, madje dhe ministri. Dolëm në ajrin e freskët të natës të dy, duke u mbajtur pas njëri tjetrit dhe përfunduam të shtrirë në stolat pranë shtëpisë së shkrimtarit. Dhe atë natë udha e qumështit rrinte varur mbi kokat tona dhe vishte me magji shtresat e bardha të atmosferës që shtriheshin si kuvertë mbi botë.

Gjatë kohës që Linda po lahej, ndeza një zjarr pranë çadrës, dhe pasi ndjeva zjarrin tek brambullinte, u shtriva sërish në rërë dhe hodha shikimin atje në pikën e errët të detit ku lahej Linda. S'kishim pak që kishim mbërritur në këtë skaj të humbur të botës dhe Linda nuk kishte duruar pa u zhytur në det. Nxora një peshqir nga çanta ime dhe i vara në një litar të shkurtër brenda çadrës të dyja çantat. Peshqirin e vendosa ndanë zjarrit dhe po e ngrohja. S'doja që Linda te ftohej. Pashë që po vinte drejt bregut dhe teksa trupi i zbulohet ngadalë, pas ajo linte si kufomë gjigante atë det të errët dhe të paanë që kutërbonte aromë kripe. E kundrova trupin e saj që kullonte ujë dhe befasi m'u zgjua dëshira ta shtrëngoja në gji deri sa të humbiste brenda meje dhe ashtu e tretur brënda organeve të mija, të mos dilte më prej aty. Të mbetej përjetësisht brënda shpirtit tim, siç mbeten ngjarjet e pakta dhe të rralla që i japin kuptim jetës sonë dhe që të fshehura nga bota me dhimbje dhe xhelozë, i marrim me vete në botën e përtejme. Ashtu i krehur në mendime, më zgjoi nga kllapia zëri i Lindës, e cila po dilte nga çadra me trikon time mbi supe. Si dhjetëra herë të tjera, me zërin e saj druajtës, më tha: - Hej, ta mora pak këtë trikon, - dhe unë si dhjetëra herë sërish i buzëqeshja asaj, muzës sime me lumturinë e përkohshme të njeriut jo-dashnor.

Qershor 2020



SI U DHA ÇMIMI I PARË NOBEL PËR LETËRSINË

Nga Dr. GUNNAR AHLSTRÖM (Anëtar i Akademisë Suedeze)

Pas shumë hezitimesh, diskutimesh, zvarritjesh dhe pikëpyetjesh edhe pa përgjigje, Akademia suedeze, i jep më 1901 dhe për herë të parë Çmimin Nobel të Letërsisë, Sully Prudhomme, René-François Prudhomme, anëtar i Akademisë franceze. Vendimi u bë publik në Stokholm, më 10 dhjetor 1901.

Ja si shkruan një nga gazetatat suedeze: “Pra nuk zgjidhet as Tolstoi, as Ibsen, as Björnson, as Mommsen, as Swinburne, as Zola, as Anatole France, as Carducci, as Mistral, as Hauptmann as edhe Echegaray, por zgjidhet Sully Prudhomme”.

Ky konstatim, me negativitet si dhe me hamendjet e tij, fsheh një debat të gjatë në vazhdim. Ai shfaq një farë situatë të brendshme të vendit i cili jep Çmimin, dhe po ashtu ndriçon në një farë mënyre, situatën letrare në vendin e fituesit.

Duke parë se Franca ishte zgjedhur vendi i cili dukej që do të priste dhënien e Çmimit, brezat e ardhshëm mund të pyesin se përse nuk iu dha Zolës apo Anatol France. Kritika letrare foli për një gjuhë ndryshe të përdorur nga personalitetet e kohës. Çmimi Nobel, ishte një terren i veçantë, i mbjellë nga një tokë akademike, me mendimtarë të rëndësishëm brez pas brezi, me njohuri të rrënjësura nga një ideal thelbësor.

Për shumë vite me radhë, fjala “ideal” diku e rrezikshme, duhej patjetër të luante një rol tepër të rëndësishëm në diskutimet relative për dhënien e Çmimit, duke u peshuar mirë në zgjedhjen e kandidatëve fitues.

Në kohën kur Alfred Nobel kishte rezervuar në testamentin e tij një çmim për letërsinë, përkrah asaj të mjekësisë, fizikës, kimisë dhe të veprave në favor të Pagues, çmimi i Letërsisë duhej dhënë nga “Akademia”.

Ky autorizim, i dha të drejtën dhe ia besoi detyrën, Akademisë suedeze, kësaj asamblejeje të rëndësishme, e cila ishte krijuar që më 1786 nga “Roi Soleil” (Mbreti i diellit) të Suedisë, Gustave III, mbështetur në përvojën e Akademisë franceze. Në fillimet e saj, kjo detyrë e papritur, u ndesh përballë situatave të vështira. Akademia presupozohej të kishte detyrime kombëtare të rëndësishme, drejt letërsisë dhe gjuhës suedeze, por jo të merrte përsipër rolin e ndërgjegjësimit internacional.

Po ashtu, Akademia u përball me komente keqdashëse ndaj literaturës së re. Viheshin në dyshim kompetencat e Akademisë.

Shpirti i saj konservator tradicional ishte në kundërshtim me letërsinë e vërtetë realiste e cila ishte kapur rreth veprave të August Strindberg në epokën e Ibsenit dhe të Björnsonit. Po ashtu, kishin filluar ta konsideronin Akademinë si një ngatërrësë në rritje dhe një reagim drejt obskurantizmit.

Kjo ishte arsyeja që u bënë përpjekje për kalimin e vështirësive duke u kërkuar zgjidhje të reja për misionin tepër delikat. Në vitin 1900 u hap biblioteka e cila do të ndiqte zhvillim e literaturës botërore, dhe mes anëtarëve të Akademisë, u krijua një Komitet special i ngarkuar të punonte për përgatitjen e dhënies së çmimit. Thembra e Akilit ishte Sekretari i Përgjithshëm i Akademisë, Dr. Carl David af Wirsén. Si poet ai ishte tepër kërkuar, katolik dhe po aq paqësor.

Si kritik i letërsisë moderne, kishte një karakter luftarak. Në gjirin e Komitetit të Akademisë ai përballonte një punë të madhe dhe shumë shpejt mori masa administrative. Mbështetur në rregulloren e vendosur për dhënien e çmimit, të gjitha aktet e kandidaturave duhet t'i nënshtroheshin kontrollit të Akademisë suedeze nga Akademia franceze, spanjolle dhe suedeze; sekretarët e burimeve njerëzore të Akademive të tjera; anëtarë të institucioneve dhe shoqatave të ngjashme me Akademinë, nga profesorë të universiteteve, mësues të estetikës, të letërsisë dhe historisë.

Pra, kjo nuk përbëhej nga një trup i vogël elektoral,

dhe ndaj u duheshin notifikuar të drejtat e tyre. Për këtë arsye u hartuan dhe shpërndanë fletoret zyrtare në gjuhën gjermane, angleze dhe franceze, të cilat u dërguan me zell në katër pikat më të rëndësishme. Propozimet duhet t'i paraqiteshin Akademisë para 1 shkurtit 1901. Rrjeta u hodh në gjithë Europën dijetare. U prit me muaj të kapej peshku i gjetur.

Hap pas hapi filluan të vijnë përgjigjet nga njëri vend në tjetrin. Ato filluan të analizohen nën fshehtësinë më të madhe. Kërshëria rritej dhe kjo për arsye që kuptoheshin. Bëhej fjalë për një shumë të konsiderueshme të hollash në jetën letrare. “Shkrimtarët e huaj për herë të parë, fillojnë të shohin larg, drejt Akademisë në Stokholm”, shkruante një figurë e shquar suedeze. “Në gjithë botën, njerëzit e letrave filluan të presin me padurim mbi cilën muzë Danaë, Këshilli suedeze, do të derdhte lumin e arit?”

Tani, pas kaq vitesh, kur mund të zbulojmë sekretin e fshehur prej kohësh nëpër dokumentet e vjetra, jemi të lumtur të ndjekim çdo etapë mbështetur në ato që dëshmojnë. Bëhej fjalë për një anketë internacionale, të pa parë ndonjëherë, dhe konstatohet me kënaqësi që Akademia e vogël e mjekrave të bardha (të vjetra) kaq herë e kritikuar, po shfaqej plotësisht në lartësinë e duhur për misionin e saj të vështirë e fisnik.

Të gjitha përgjigjet e ardhura nga vendet e ndryshme me fletoren zyrtare, ishin regjistruar me kujdes sipas rendit alfabetik të dërguesve për t'u shpërndarë më pas të

rikopjuara, tek gjithë anëtarët e Akademisë, në përgjithësi dhe Komitetit Nobel në veçanti.

Në krah të Sekretarit të Përgjithshëm me shpirt luftarak, ndodhej një profesor i historisë tepër i njohur në gjuhën romane, po ashtu në letërsi; gjuhëtar i shquar i gjuhëve skandinave herë pasardhës e herë homonim i Esaia Tegner, “mjekra klasike” e Suedisë, i vetmi poet cilësor, Konti Carl Snoilsky, drejtor i Bibliotekës mbretërore të Stokholmit.

Fletët e grumbulluara njëra pas tjetres mbi tavolinat e Akademisë suedeze, japin në një farë mënyre imazhin tipik të letërsisë europiane, në fillim të shekullit.

Britania e madhe, ky vend ishullor, gjithmonë i rezervuar, paraqitet një njollë e bardhë në hartë. Asnjë propozim, asnjë emër i shënuar. Polonia prezantohet hijshëm me Henry Sienkiewicz kandidatura e të cilit mbrohej me inteligjencë nga dy historianë të njohur suedez.

Gjermania një vend me kokën pas nga impulset energjike të Guillaume II, kërkon t'i dëgjohet zëri në një dokument (plein d'emphase). Një profesor në Dresde rekomandon me forcë që të merret në konsideratë një këngëtar pothuajse i panjohur, për “talentin e tij lirik tepër të madh”.

Po ashtu një grup i shoqëruar nga një figurë e njohur në fushën e historisë, një shtytje e madhe e shkencës emri i të cilit sot është bërë i njohur nga publikimet klasike. Gjuhëtar i roman, me në krye profesorin e vjetër të Ienas, W.Cloetta, e kthejnë kokën nga bregu i Rinit dhe i Ronit duke tërhequr vëmendjen tek një poet provincial Frédéric Mistral.

Përballë këtyre veprimeve të shpërndara, shpesh me kërshëri, siguria e rutinës bie në përgjigjet e herëpashershme të Francës, vend nga i cili prej shumë kohësh, jemi mësuar të marrim të veçanta akademike të rekomanduara.

I madhi Marcelin Berthelot nuk ka nevojë për shumë fjalë në prezantimin e kandidaturës së Emil Zolas; I zgjedhur në Akademinë franceze më 1900, në cilësinë e anëtarit, propozon një shkrimtar të frymëzuar nga shkencat natyrore dhe liberalizmi demokratik. Edmond Rostand nuk ka nevojë as ai për elozhe të shumta : u propozua nga Paul Hervieu në garancinë e Cyrano de Bergerac dhe Aiglon. Gjithçka është shprehur qartë dhe në mënyrë të përmbledhur.

Përsëri fjalë e argumente disi më të ngatërruara, i janë kushtuar një tjetër kandidati ku dukej hapur mbështetja



Sully Prudhomme, René-François Prudhomme,

energjiqe dhe një marrëdhënie sigurie e padiskutueshme

Larg hapësirave të Parnasse, pak i njohur si jashtë si edhe në Suedi, bëhej fjalë për René Vallery-Radoti, cili u bë shkak i një veprimi të bashkërenduar në favor të biografisë së vjehrrit të tij “Jeta e një Pastori”.

Duke qenë se ishte nipi i Eugène Sue dhe Emile Legouvé, bashkëpunëtori i parë i Buloz tek “Revue des deux Monde”», (Revista e dy Botëve) ai ishte familjarizuar me sukseset e letërsisë. Nuk do të gabohej supozimi që prania e tij mes nobelistëve rezulton si goditje e fortë alarmi. Ai u propozua si fillim nga Melchior de Vogué, më pas Stokholmi u bombardua në disa ditë rresht, nga tekste të mrekullueshme, miratuar nga figura të njohura si Ernest Legouvé, Albert Vandal, Gabriel Hanotaux, Albert Sorel, Sully Prudhomme e Henri Lavedan. Të gjithë shfaqin mendimin se “Jeta e një Pastori” është një vepër letrare e jashtëzakonshme në kuptimin e idealizmit. Zhurma e kësaj fushate kishte mbërritur deri në Paris u hapi rrugën manifestimeve të pakënaqësisë nga ana e Kolegjit të Francës ku Paul Meyer rekomandon Mistral, me një shënim anësor “Vallery-Radot propozuar nga Vogué, është një arritje...”.

Një rrëmujë e tillë nuk kishte gjë tjetër për qëllim, veçse të shpërqendronte vëmendjen e Komitetit. Efekti i tij, në fakt u ekuilibrua nga Akademia -simotër e Parisit-e cila gjeti mbështetje nga firma të tjera letrare, me propozimin e një kandidature fisnike, e shkallës së parë.

Sully Prudhomme hyn mes kandidaturave të nobelistëve nga një tekst tepër i rëndësishëm datuar më 10 janar 1901 dhe firmosur nga Gaston Paris, Gréard, Paul Bourget, Gaston Boissier, André Theuriet, Henry Houssaye, François Coppée, Ludovic Halévy, Henri de Bornier, José-Maria de Hérédia, Jules Lemaitre, C.de Freycinet e Emille Deschanel. Tekst aprovohet po ashtu edhe nga Emile Olivier, Costa de Beauregard e Emile Faguet.

Ky manifestim masiv i natyrës gjysmë zyrtare, eklipsoi në votimin e shpërndarë shteteve të tjera si Italia, Greqia, Norvegjia madje dhe vetë Suedia ku Gaston Paris ishte rekomanduar nga një kolegët e tij adhurues, në Universitetin e Upsalas.

Me gjithë këto ndërhyrje të gjata, zgjedhja nuk ishte dhe aq e vështirë, ku pas marrjes së vendimit përfundimtar nga Akademia në një seancë plenare më 14 nëntor, Sully Prudhome, u lajmërua se çmimi i ishte akorduar “në mirënjohje të meritave të veçanta që ai ka treguar si autor deri në vitet e fundit, dhe në veçanti për poezinë e tij e cila dëshmon një idealizëm të arrirë, në një përsosmëri artistike dhe me një ndërthurje kaq të rrallë të cilësive të shpirtit dhe të gjeniut”.

Që në 19 nëntor mbërriti një letër me një përgjigje tepër elegante ardhur nga Châtenay, vendi ku ai banonte. “Ndiej krenari të pakufishme dhe lumturohem duke menduar nderin e një instance kaq të lartë dhe kërkuar nga shumë shkrimtarë të tjerë më lartë se unë, kjo fitore i shkon atdheu tim, të cilit i detyrohem për këtë nderim e vlerësim të veprës sime”.

Dhe duke qenë se këtu nuk bëhet fjalë vetëm për fitore, por edhe 208.950 franga, fituesi jep me kënaqësi të dhënat e llogarisë së bankës në Paris.

Publiku nuk ishte ende në dijeni dhe fituesit i ishte lutur, të mbante fshehtësinë, derisa të behej dorëzimi zyrtar i çmimit më 10 dhjetor, datë e vdekjes së Alfred Nobel.

Dihej mirë që profesor Roentgen, ndodhej në Grand Hotel, dhe prania e tij kuptohej, ishte e justifikuar për Çmimin në Fizikë. Vetëm të ftuarit e dinin që ambientet për letërsinë nuk do të ziheshin.

Që në fillim, Sully Prudhomme, kishte deklaruar se për arsye të një sëmundjeje të gjatë, nuk mund të paraqitej. Kjo në fakt i prishte pak planet e organizimit. Prania e tij nën uniformë, natyrisht që do të bënte efektin e vetë të veçantë gjatë ceremonisë. Nën kujdesin e Komitetit të Nobelit, përkthimi i esesë së Gaston Parisit rreth Sully Prudhomme, u publikua në Francë në koleksionin “Mendimtarë e poet”, shpërndarë në të gjitha libraritë suedeze, në të njëjtën ditë të dhënies së Çmimit Nobel.

Me modelin e epokës së vjetër ceremonia u organizua në sallën e Festave, të Akademisë së Muzikës, zbukuruar me shtylla ndriçuara magjishëm, gjithë lule, në praninë e përfaqësisë, të qeverisë dhe po ashtu zbukuruar nga një pjesë e madhe fisnikësh.

Gjithashtu më pas ceremonia u shoqërua nga një banket pritjeje gjithë hijeshi i të njëjtit nivel, ku buronte latinishtja me vargjet “Ad anniversarium primun institutionis Nobeliane” (Në përvjetorin e parë të Institucionit të Nobelit).



Medalja e Çmimit Nobel për Letërsinë

Jetohej në atë epokë ku zinin vend fjalët e mëdha me frazat e gjata, të ngatërruara, të cilat përmbanin një amalgamë kuptimesh nga një anë ezoterike dhe po aq dehëse.

Çmimi i akorduar Sully Prudhomme në emër të tij dhe në emër të atdheut, u tërhoq nga Ministri Francës, zoti Marchand, ku “veshja e thjeshtë dhe demokratike”, sipas komenteve të shtypit, “as një kordon në kostumin e tij të zi”, nuk bënte kontrast para shkëlqimit të gjelbër suedez.

Por çfarë mendonte vetë Sully Prudhomme i tërhequr në Francë ? Disa ditë më vonë i intervistuar nga një gazetar i “Le Figaro”, ai shfaqej i gëzuar dhe i çuditur për çmimin që i ra si nga qielli, po ashtu dhe shuma pothuajse e njëjtë me ato që kishte fituar nga poezitë e tij, në këto tridhjetë e pesë vjet.

“Mendoj kolegët e mi të rinj, të cilët nuk kanë mundësinë të botojnë poezitë në fillimet e tyre. Kam dëshirën që një pjesë t’ua fal atyre që nuk mundën të botojnë librin e tyre të parë me poezi. Deri tani kam marrë një lumë kërkesash, shuma e të cilëve e kalon krejt Çmimin”.

Sully Prudhomme nuk ishte i pari që u çudit. E papritura nuk ishte po aq e vogël edhe në Suedi, ku çmimi i tij provokoi një reaksion të veçantë.

Katër ditë pas shpalljes së çmimit, një peticion i firmosur nga 43 shkrimtarë dhe artistë të njohur me në krye Auguste Strindberg e Selma Lagerlof, publikuan:

“Leon Tolstoit,

Me rastin e marrjes së çmimit Nobel të Letërsisë që iu akordua për herë të parë, ne të nënshkruarit, shkrimtarë, artistë dhe kritikë suedezë, dëshirojmë t’ju shfaqim habinë tonë. Ne nuk shohim në personin tuaj vetëm një patriark të nderuar të letërsisë moderne, por edhe një nga poetët më të mëdhenj që sipas mendimit tonë, duhej marrë në konsideracion, dhe pse ju vetë, personalisht, asnjëherë nuk keni kërkuar një shpërblim. Ne besojmë se është detyra jonë që t’ju drejtohem, pasi mendojmë se institucioni i ngarkuar për të dhënë çmimin në fjalë, duke parë përbërjen e tij aktuale, në asnjë moment nuk është shprehur në favor të artit, apo konform opinionit në përgjithësi. Nuk pranohet prej jashtë kufijve, arti i mendimit të lirë dhe krijimit të lirë e ky nga vetë ana e popullit të largët, nuk është vlerësuar si më i miri dhe më i qëndrueshmi”.

Sipas këtij dokumenti, mund të krijohet idea se Léon Tolstoi paraqiste në Suedi një rëndësi të madhe, i vetmi, dhe se vepra e tij kishte lënë gjurmë të thella në letërsinë e vendit. Por ja që nuk ishte kështu.

Ishte një klasik, dhe një simbol i pastër i cili stimuloi mendimin e pavarur në Rusinë e carëve, por asgjë më tepër.

Përsa i përket Çmimit Nobel, ai krijonte një trampolinë të favorshme politike dhe një sulm kundër armikut të përjetshëm: Akademia suedeze.

I moçmi i Jasnaia Polianas as nuk i shkonte mendja që do të përdorej si një instrument polemike, por nuk mund t’i shmangej simpatisë. Përgjigjja e tij, drejtuar protestuesve suedeze, ishte karakteristike:

“Jam ndier shumë i kënaqur që nuk m’u dha Çmimi Nobel. E para, kjo do të më krijonte mjaft ngatërresa, të paturit e kësaj shume, para që sipas mendimit tim do të më sillnin vetëm të këqija, ngatërresa dhe e dyta, jam ndier i nderuar dhe i kënaqur pa masë, të shoh shprehjen e një simpatie kaq të madhe të figurave të rëndësishme dhe po ashtu të atyre që nuk i njoh fare”.

Pra, i pari Çmim Nobel nuk mori as vlerësime dhe as preference letrare. Nën dritën e përvojave këto dhjetë vitet e fundit, karakteri i saj zyrtar i lëvizjes internacionale të mirësjelljes është vënë mjaft në dukje.

Nderi nuk u bëhej aq poetëve melankolikë të epokës së Parnasse se sa Francës letrare që prej kohësh mbetet një stimulues i rëndësishëm.

Përgjatë ceremonisë, sekretari elokuent dhe organizuesi i Çmimit, i dërgoi Akademisë franceze, një nderim “nga simotra e saj suedeze që ishte e lumtur t’i niste nga vendi i Tegner dhe Geijer, një dëshmi të nderuar, vendit i cili kishte parë lindjen e figurave si Racin, Corneille e Viktor Hygo”.

Po kështu, në të njëjtën atmosferë pritej Çmimi Nobel i Sully Prudhomme. Akademia suedez me kënaqësi dhe krenari hodhi në Gazetën Zyrtare “Journal Officiel”, letrën e falenderimit të simotrës së saj franceze, letër kjo e firmosur nga Gaston Boissier: “I ngarkuar nga anëtarët e Akademisë franceze që me ftesën e Akademisë suedeze, ka propozuar me zgjedhjen e saj Sully Prudhomme, ju lutet ta falënderoni, në emrin e tyre, për çmimin që iu atribuuu. Nderi i bërë, u mirëprit në gjithë vendin. Zoti Sully Prudhomme, është i vlerësuar dhe i dashur nga të gjithë për karakterin dhe talentin e tij. Ne i jemi mirënjohës dinjitetit të jetës së tij, vlerësimit të ndjenjave e mbi të gjitha të besimit ndaj çështjes së idealit, që ky çmim ka dashur t’ia vër në dukje.

Akademia franceze së cilës ai i përket prej njëzet vitesh, ndihet krenare për të; ajo i dërgoi në zyrën e tij ku është tërhequr për shkak të sëmundjes, falënderimet, e veçanërisht për rrezatimin që i transmetoi gjithë vendit. i lumturuar që me këtë rast, jam përçuesi i simpatisë së saj kundrejt një shoqërie letrare me të cilën ne ndihemi të bashkuar, dhe pse larg, nga një organizim i ngjashëm, nga përbërja e punës dhe i të njëjtit kult të letrave”.

Përktheu nga frëngjishtja MIMOZA KUCHLY



KUR JAMES JOYCE DHE MARCEL PROUST U TAKUAN NË VITIN 1922 DHE U MËRZITËN TMERRËSISHT NGA NJERI TJETRI

Kur përmendim emrat e artistëve të mirënjohur të së shkuarës, u referohemi veprave të tyre më të vlerësuara – për shembull, Orson Welles na kujton *Qytetarin Kane* ose *Luftën e botëve*, dhe H. G. Wells na kujton *Makina e kohës* ose... *Luftën e botëve*. Dhe kur të dy artistët u takuan në vitin 1940, zbuluan se botët e tyre, të cilat tashmë ishin ndërthurur në filmin famëkeq të Welles-it, kishin goxha për të folur së bashku, duke shkëmbyer përziemërsisht histori, idera dhe admirim reciprok.

Një tjetër takim historik ndërmjet dy artistëve të cilin mund ta konsiderojmë të ngjashëm, ai midis James Joyce-it që njihet për *Uliksin*, dhe Marcel Proust-it që njihet për *Në kërkim të kohës së humbur*, nuk solli një bisedë kaq të këndshme.

Siç ka vënë në dukje kritiku irlandez, Arthur Power:

“Ja tek takohen dy figurat më të mëdha të letërsisë së kohës sonë, dhe e pyesin njëri-tjetrin nëse i pëlqejnë tartufët.”

Ky të paktën është njëri version i kësaj ngjarjeje në maj të vitit 1922, kur Proust-i po i afrohej fundit të jetës. Takimi u bë në një festë të organizuar për Igor Stravinsky-n dhe Sergei Diaghilev-in, në Hotel Majestic. Të dy ishin lexues të etshëm, me memorie të shkëlqyera (siç e dimë me siguri për Proust-in) dhe i kuptonin me intuitë mekanizmat kulturorë të modernitetit. Ata mund të bënin biseda kaq serioze....

Megjithatë, një pjesëmarrës me emrin William Carlos Williams, e përshkruan në mënyrën më komike....

Ben Jackson i *London Review of Books* shkruan: “Joyce-i mbërriti i dehur dhe i veshur keq, ndërsa Proust-i, me një gëzof të hedhur mbi supe, hapi derën”.

Më pas, shkruan Williams, “të dy burrat u ulën në karrige krah njëri-tjetrit, ndërsa “mbështetësit” prisnin “shkëndija prej fjalëve të mençura”.

Ndërsa ata biseduan për sportet e për motin, sikur të ishin dy të moshuar që po takoheshin në sallën e pritjes për t’u vizituar te doktori, apo dy personazhe të Samuel Beckett-it, të munduar nga ankesat e papërfillshme me rëndësi madhore.

“Kam përditë dhimbje koke. Sytë i ndiej shumë keq”, - tha Joyce-i.

Proust-i ia ktheu:

“Stomaku im i gjerë. Si do t’ia bëj? Po më dhemb. Në fakt, duhet të largohem menjëherë”.

“Ndodhem në të njëjtën situatë”,-iu përgjigj Joyce-i. “Sikur të gjej dikë që të më mbajë për krahun. Mirupafshim!”

“Charmé”, -tha Proust-i. “Oh, stomaku im, stomaku im”.

Ford Madox Ford e konfirmon këtë version, por siç tregon Richard Ellmann, që është biografi më i respektuar i Joyce-it, organizatori i festës, romancieri Sydney Schiff, e mohon atë. Nuk duket se Ellmann favorizon ndonjë version të caktuar, megjithatë, ai na tregon versionin e Joyce-it, i cili është dhënë shumë herë.

Autori i *Uliksit* mbante mend se “biseda e tyre përmbante vetëm fjalën ‘Jo’. Proust-i më pyeti nëse e njihja filan njeri. I thashë, ‘Jo’”. Ndërsa Proust-i u pyet nëse e kishte lexuar *Uliksin*, dhe ai u përgjigj gjithashtu negativisht. “Ishte një situatë”, kujton Joyce-i, “e pamundur”. Të ftuar të tjerë e mbanin mend në mënyrë të ngjashme takimin.


Në një version tjetër ne shohim se çfarë ndodh pas diskutimit të tyre – një rrëfim që i përngjan një skenari të një mbrëmjeje që mbyllet me zhgënjim. Bashkëshortja e Sydney Schiff-it, Violeta, kujton se Joyce-i i dehur u fut në një taksi bashkë me këta të dy dhe Proust-in, e hapi direkt dritaren. “Duke ditur frikën paralizuese që Proust-i kishte ndaj rrymës së erës”, shkruan një faqe për Proust-in, Violeta “e mbylli menjëherë dritaren”. Kur taksia mbërriti tek apartamenti i Proust-it, romancieri francez e “nxiti irlandezin që ta lejonte taksistin ta çonte deri në shtëpi”, e më pas “shpejtoi për tek apartamenti i tij”.

Interpretimet e shumta kundërshtuese, duket se bashkohen në një pikë: takimi ishte i pavlerë. Megjithatë, një shkrimtar botoi së fundmi atë që pretendohet se është një libër i tërë mbi këtë temë. Edhe ai mbërrin në konkluzionin se “askush nuk mund ta thotë me siguri se çfarë folën me njëri-tjetrin”. Është tunduese të mendosh se mund të kishte shkuar ndryshe, nëse do të ishin takuar më herët ose në rrethana të tjera, duke marrë parasysh prirjen e Joyce-it për të pirë me tepri dhe shëndetin e dobët të Proust-it e antipatinë e tij ndaj shoqërisë. Revista *The New Inquiry* citon një koment që Joyce-i i bëri Samuel Beckett-it për Proust-in: “Nëse do të na kishin lejuar të takoheshim e të bisedonim diku...”

Megjithëse thuhet që të dy shkrimtarët rrëfyan se nuk ia kishin lexuar librat njëri-tjetrit, Jackson vëren se kur Joyce-i “pranoi që u kishte hedhur një sy disa faqeve, deklaroi se nuk kishte dalluar ‘ndonjë talent të veçantë’”. Ai gjithashtu shfaq njëfarë zilie për rrethanat e rehatshme të Proust-it. Proust-i, i cili vdiq gjashtë muaj më vonë, nuk përmendi ndonjë gjë për takimin që pati.

Përktheu David Hudhri





Për kuptimin e jetës, pasi ia hoqën dënimin me vdekje

DOSTOJEVSKI: SOT ISHA TE PORTA E VDEKJES

Nga Maria Popova

“Do të punoj jashtëzakonisht shumë”, kishte vendosur i riu Fjodor Dostojevski (1821-1881) ndërsa mendonte për të ardhmen letrare, duke iu lutur nënës së tij të varfër t’i blinte libra. Në moshën njëzet e shtatë vjeçare, u arrestua ngaqë ishte pjesë e një shoqërie letrare që qarkullonte libra që ishin përcaktuar të rrezikshëm nga regjimi carist. U dënua me vdekje. Më 22 dhjetor 1849, u çua në një shesh publik në Shën Petersburg, së bashku me një grusht të burgosurish të tjerë, ku duheshin ekzekutuar për t’u bërë shembull paralajmërimi për masat popullore. U lexua dënimi me vdekje, u veshën me këmbisha të bardha, veshja para ekzekutimit, dhe u lejuan të puthin kryqin. Tre nga tre, ata u vendosën kundrejt shtyllave prej druri ku duhej të kryhej ekzekutimi. Dostojevski, i gjashti në radhë, u vetëdijesua plotësisht se i kishin mbetur pak çaste për të jetuar.

Dhe pastaj, në minutën e fundit, u bë një njoftim pompoz që cari po ua falte jetën, i gjithë spektakli ishte orkestruar si një marifet i bujshëm mizor për ta nxjerrë despotin si sundimtar mirëdashës. Dënimi i vërtetë u lexua më pas: Dostojevski duhej të kalonte katër vjet në një kamp pune të Siberisë, dhe më pas disa vite shërbimi të detyrueshëm ushtarak në forcat e armatosura të carit, në ekzil. Do të ishte gati dyzet vjeç kur të merrte sërish penën për të rifilluar ambiciet letrare. Por tani, kur sapo shpëtoi vdekja, pasi një fije peri e ndante nga ajo, Dostojevski mori

frymë i ngazëllyer, u rilind me një mall të ri për jetën.

E shpërfaq i ngazëllimin e tij në një letër mahnitëse për të vëllain, Mikhailin, i shkruar disa orë pas ekzekutimit të kthyer në shfaqje i cili gjendet në vëllimin e parë të përmbledhjes së plotë, tashmë të botuar, e cila përmban thesarin e letrave të vitit 1988 shkruar nga Dostojevski.

Një shekull para se i mbijetuari i Holokaustit, Viktor Frankl na siguroi pas një kalvari të vështirë se “gjithçka mund t’i marrësh njeriut, por një gjë s’mundesh: më të fundit e lirive njerëzore, mënyrën si ti zgjedh të përballesh me rrethanat”. Dostojevski shkruan:

“Vëlla! Nuk jam i dëshpëruar dhe nuk jam shkurajuar. Jeta është kudo, jeta është brenda nesh, jo jashtë. Do të ketë njerëz pranë meje, dhe të jem një qenie njerëzore midis njerëzve, të mbetesh njeri përgjithmonë, pa marrë parasysh se në çfarë rrethanash je, të mos të shtohet dëshpërimi dhe të mos shkurajohesh, kjo është jeta, është detyra e saj. E kam pranuar këtë. Kjo ide ka hyrë në mishin dhe gjakun tim ... Koka që krijon, jeton jetën e lartësuar të artit, që pranoi dhe u mësua me kërkesat më të larta të shpirtit, ajo kokë tashmë është prerë nga shpatullat e mia ... Por mbetet tek unë, zemra dhe i njëjti mish dhe gjak që gjithashtu mund të duan, të vuajnë, të ndjejnë keqardhje, dhe mos harro, edhe kjo është pjesë e jetës!”

Prapëseprapë, edhe përmes këtij gëzimi, kësaj force gjallëruese të qenies, identiteti i tij si shkrimtar e çon drejt dëshpërimit të thellë. “A do të ndodh ndonjëherë që ta marr sërish penën në dorë?” pyet përpara një të ardhmeje të zymtë gjatë katër viteve të ardhshme në kampin e punës. “Nëse s’do të jem në gjendje të shkruaj, do të zhdukem si krijues. Më mirë pesëmbëdhjetë vjet burgim dhe një penë në dorë!” Por ai shpejt i rikthehet mirënjohjes që ishte gjallë dhe, duke e siguruar vëllain e tij të mos shqetësohej për të, vazhdon:

“Nuk jam shkurajuar, ta dish dhe shpresa s’më ka braktisur ... Në fund të fundit, sot isha tek porta e vdekjes, jetova me atë mendim për pesëmbëdhjetë minuta, u përballa me çastin e fundit, dhe tani jam përsëri gjallë!

Duke lënë një testament të bukur për faktin thelbësor se kur kuptimi për drejtësinë vdes, ajo që mbetet midis njerëzve të mirë është vetëm dashuria, ai shkruan:

“Nëse dikush më kujton për keq, dhe nëse jam zënë me ndokënd, nëse i kam bërë përshtypje të keqe ndokujt, thuaju t’i harrojnë nëse i takon. Në shpirtin tim nuk ka asnjë zemërim apo mëri, do të doja të doja dhe përqafoja të paktën dikë nga e kaluara në këtë çast. [...] Kur hedh sytë nga e kaluara dhe mendoj se sa kohë kam shpenzuar kot, sa shumë prej saj e kam humbur mes iluzionesh, gabimesh, kotësish, me pamundësinë për të jetuar; si nuk arrita ta vlerësoja, sa herë mëkatova kundër zemrës dhe shpirtit tim – kur e kujtoj këtë, më dhemb zemra. Jeta është një dhuratë, jeta është lumturi, çdo çast mund të kishte qenë një përjetësi lumturie. Por i riu si veriu!”

Gjysmë shekulli më parë Oskar Uajldi shkroi letrën e tij të jashtëzakonshme për vuajtjen, si forcë e shndërrimit dhe transcendencës nga burgu, ku u internua për shkak se kishte të dashur atë që donte, Dostojevski shton:

“Tani, që jeta po më ndryshon, po ripërtërihem në një formë të re. Vëlla! Të betohem se s’do ta humbas shpresën dhe do ta ruaj zemrën dhe shpirtin të pastër. Unë do të rilind për mirë. Kjo është e gjithë shpresa ime, i gjithë ngushëllimi im.

Jeta në kamp tashmë ka vlarë mjaftueshëm tek unë nevojat e mishit që s’ishin plotësisht të pastra; më parë, kujdesesha pak për veten. Tani mungesat s’më ngjallin as më të voglin shqetësim, dhe për këtë arsye mos ki fare frikë se vështirësitë materiale do të më vrasin”.

Meqenëse unë vetë kam kaluar vite në mungesa materiale, megjithëse kurrë, për fat të mirë, në masën që duroi Dostojevski, dhe jam gjithnjë mirënjohëse për mënyrën sesi ato kohë më kalitën, si më bënë të kem më pak frikë nga varfëria dhe vështirësitë, të ndërmarrë rreziqe që të tjerët nuk i merrnin, të ndjek shtigje më pak të sigurta në aspektin material në jetë, s’mund të mos përpiqem të përfytyroj se sa shumë e ka nxitur kjo përvojë e mundimshme këmbënguljen e jashtëzakonshme të Dostojevskit si artist kundër baticave të konvencioneve dhe fantazmave të vazhdueshme të varfërisë. Padyshim që gjen jehonë tek “Shënimet nga nëntoka”, “Krim dhe ndëshkim”, dhe veçanërisht “Vëllezërit Karamazov”. Ai shpërfaq tek to idetë e tij për kuptimin e jetës, të paraqitura dekada më vonë nën maskën e një ëndrrë dhe frymëzoi këmbënguljen për detyrën ekzistenciale për ta parë mirësinë tek njerëzit “pavarësisht nga bollëku në të gjitha llojeve e mjeranive”.

Tek këto letra has një përvojë të ngjashme me të një neurokirurgu të ri që zbulon kuptimin e jetës pasi përballet me vdekjen dhe kupton si Uolt Uitmani se çfarë ka vlerë në jetë, pastaj lexojmë letrat për Anën, dashurinë e jetës së Dostojevskit, e cila e shpëtoi nga varfëria dhe burgu që priste pasi huadhënësit hapën proces gjyqësor, dhe në fund sekretin e një martese të lumtur.

Përktheu nga anglishtja: GRANIT ZELA

I I HUAJI

- Thuamë, kë do më shumë, njeri i mistershëm, atin, nënën, motrën, apo vëllanë?
- Nuk kam as atë, as nënë, as motër, as vëlla.
- Miqtë e tu?
- Tani po përdorni një fjalë së cilës gjer më sot s'ia di kuptimin.
- Atdheun tënd?
- Nuk e di as se ku ndodhet.
- Bukurinë?
- Do ta doja me gjithë zemër, perëndeshë dhe të pavdekshme.
- Arin?
- E urrej, sikurse ju urreni Zotin.
- Epo atëherë, çfarë do ti, i huaj i jashtëzakonshëm?
- Unë dua retë... retë që përshkojnë qiellin... atje tutje... atje tutje... të mrekullueshmet re!

II DËSHPËRIMI I PLAKËS

Plaka e regjur dhe e fishkur u ngazëlye krejt kur pa atë fëmijë të bukur, të cilit të gjithë sa ishin përpiqeshin t'i bënë qejfin dhe t'i pëlqenin; atë qenie të bukur, po aq të brishtë sa plaka e vogël, dhe po si ajo, pa dhëmbë e pa flokë.

Dhe plaka iu afrua që ta përkëdhelte e ta gëzonte. Por fëmija i tmerruar filloi të përpëlitej nën përkëdheljet e gruas së drobitur dhe shtëpia ushtoi nga kuisjet e tij.

Atëherë, plaka e shkretë u tërhoq në vetminë e saj të përhershme dhe, duke qarë në një kënd, thoshte me vete: "Ah! Mjerë ne femrat e plakura që na ka kaluar mosha për t'iu pëlqyer njerëzve, madje edhe të pafajshmëve; ne u kallim datën fëmijëve të vegjël që duam të përkëdhelim!".

III CONFITEOR I ARTISTIT

Sa depërtuese janë muzgjet vjeshtore! Ah! Depërtuese gjer në dhimbje! Sepse ekzistojnë disa ndjesi fort të këndshme që, ndonëse të mjegullta, janë të fuqishme; dhe nuk ka majë më të mprehtë sesa ajo e Pafundësisë.

Ç'kënaqësi e madhe është të kredhësh vështirmin në hapësirën e pafundme të qiellit e të detit! Vetmi, heshtje, dëlirësi e pakrahueshëm e kaltërsisë! Një velë e vockël që fërgëllon në horizont dhe që, me vogëlsinë dhe vetminë e saj, imiton jetën time të pandreqshme, melodi monotone e valëve; të gjitha këto mendojnë nëpërmjet meje, ose unë mendoj nëpërmjet tyre (sepse në madhështinë e ëndërrimit kuptimi i unit humbet shpejt!); ato mendojnë, them unë, por në një mënyrë muzikore dhe piktoreske, pa stërhollime, pa silogjizma, pa përfundime.

Sidoqoftë, këto mendime, pavarësisht nëse dalin prej meje apo burojnë prej gjërave, shumë shpejt bëhen tepër të fuqishme. Dhe energjia e kënaqësisë të krijon një shqetësim e një vuajtje pozitive. Nervat e mia tepër të tendosura nuk japin tashmë veç ca dridhje çjerrëse e të dhimbshme.

Tani thellësia e qiellit më pikëllon; qartë-



CHARLES BAUDELAIRE

Brenga e Parisit

Poema në prozë

I PËRKTHEU NGA ORIGINALI BESIANA KADARE

sia e tij më acaron. Pandjeshmëria e detit, pandryshueshmëria e pamjes, më revoltojnë... A duhet vallë pambarimisht të vuash apo t'i largohesh pambarimisht Bukurisë? Natyrë magjiplote dhe e pamëshirshme, kundërshtare gjithmonë fitimtare, lërmë! Mjaft i tundove dëshirat dhe krenarinë time! Studimi i Bukurisë është një dyluftim, ku artisti klith nga tmerri përpara se të dorëzohet.

IV NJË HOKATAR

Festimi i Vitit të Ri kishte arritur kulmin e vet; një rrëmujë balte dhe dëbore, e përshkruar nga mijëra karroca, e përndritur nga lojërat e bonbonet, gëluese në lakmira e dëshpërime; është marrëzia zyrtare e një qyteti të madh, e aftë të turbullojë edhe mendjen e vetmitarit më kokëfortë.

Në mes të kësaj katrohure të potershme, një gomar ecte me gjallëri, ndjekur nga një harbut i armatosur me një kamxhik.

Në çastin kur gomari po merrte kthesën e një rruge, një zotëri bukurosh me doreza, i lustruar, mizorisht i kravatuar e i burgosur në një kostum

fringo të ri, u përkul në mënyrë ceremoniale përpara kafshës së përlurur dhe i tha duke hequr kapelën: "Ju uroj një vit të mbarë e të lumtur!". Pastaj u kthye nga miqtë e tij me një pamje mburraveci, si të kërkonte miratimin e tyre për të kurorëzuar suksesin e vet.

Gomari as nuk e vuri re këtë hokatar të hollë dhe vazhdoi të vraponte me zell atje ku e thërriste detyra.

Kurse mua më zuri papritur një tërbim i pakufishëm kundër këtij tyrfyli të përsosur, që m'u duk se mishëronte krejt mendësinë dhe humorin francez.

V DHOMA DYSHE

Një dhomë që i ngjan një ëndrre, një dhomë me të vërtetë shpirtërore, në të cilën atmosfera e amullt është lehtë e ngjyruar në rozë e në blu.

Aty shpirti kridhet në një banjë plogështie, të aromatizuar me keqardhje e dëshirë. - Është një mugëtitirë e kaltër dhe e trëndafilte; një ëndërr epshndjellëse gjatë një eklipsi.

Orenditë kanë trajta të zgjatura, të kapitura, të mekura. Duken sikur ëndërrojnë dhe jetojnë në

një gjendje somnambulike, njëlloj si bota bimore e minerale. Stofrat flasin një gjuhë të heshtur, sikurse lulet, qiejt, diejt që perëndojnë.

Mbi mure, asnjë ndotje artistike. Në krahasim me ëndrrën e kulluar, me ndjesinë e paanalizuar, arti i përcaktuar, arti pozitiv, është një blasfemi. Këtu gjithçka ka qartësinë e mjaftueshme dhe errësirën fort të këndshme të harmonisë.

Një kundërmim fare i lehtë, i përzgjedhur me shije të përsosur dhe i përzier me një notë lagështire, noton në këtë atmosferë ku mendja e dremitur përkundet nga ndjesi që të kujtojnë serrat e ngroh-ta.

Tyli bie si shi i dendur mbi dritare e mbi shtrat; ai derdhet si ujëvarë dëbore. Dhe mbi këtë shtrat është shtrirë Idhulli, mbretëresha e ëndrrave. Po si vallë ndodhet ajo këtu? Kush e solli? Ç’fuqi magjike e vendosi mbi këtë fron ëndërimi e kënaqësie? Po ç’rëndësi ka? Ja tek është! Unë e njoh.

Ja tek janë ata sy, flaka e të cilëve përshkon muzgun; ata sy të mprehtë e të tmerrshëm që i njoh nga djallëzia e tyre e frikshme. Ata tërheqin, magjepsin, përpijnë vështrimin e kokëshkretit që i sodit. I kam studiuar shpesh këta yje të zinj që zgjojnë kureshtjen dhe adhurimin.

Cilit demoni zemërmirë duhet t’ia di për nder që gjendem kështu i rrethuar me mister, me heshtje, me paqe dhe parfume? O lumturi e përsosur! Ajo që ne zakonisht quajmë jetë, edhe në shprehjen e saj më të lumtur s’ka asgjë të përbashkët me këtë jetë kaq të epërme që po njoh tani e që po shijoj minutë pas minute, sekondë pas sekonde!

Jo! S’ka më minuta, s’ka më sekonda! Koha është zhdukur; përjetësia mbretëron, një përjetësi ëndjesh!

Por një trokitje dere e tmerrshme, e rëndë, osh-tin dhe, si në një ëndërr skëterre, më duket sikur marr një goditje kazme mu në lukth.

Dhe atëherë një Fantazmë hyn brenda. Është një ftues gjyqi që vjen të më torturojë në emër të ligjit; është një dashnore e ndyrë që vjen të ankohet e t’i shtojë banalitetet e jetës së saj dhimbjeve të asaj simes; ose shegerti i një drejtori gazete që kërkon vazhdimin e dorëshkrimit.

Dhoma parajsore, idhulli, mbretëresha e ëndrrave, Silfida siç thoshte i madhi René5, e gjithë kjo magji u zhduk nga trokitja e dhunshme e Fantazmës.

O tmerr! Tani më kujtohet! Më kujtohet! Po! Kjo karakatinë, ky vend ku mbretëron mërzia e përhershme, është tamam i imi. Ja ku janë orenditë budallaqe, të pluhurosura, të ciflosura; vatra pa zjarr e ndotur nga të pështyrat; dritaret e trishtuara, mbi pluhurin e të cilave shiu ka lënë vazhda; dorëshkrimet plot shkarravina ose të papërfunduara; kalendari mbi të cilin lapsi ka shënuar datat ogurzeza!

Dhe ai parfum i tjetërbotshëm, që dehte ndjeshmërinë time të rafinuar, medet! është zëvendësuar nga një kundërmim i qelbur duhani, përzier me nuk di çfarë myku të neveritshëm. Tani këtu mund t’i mbash erë thartirës së dëshpërimit.

Në këtë botë të ngushtë, por kaq të pështirë, veç një send i njohur më buzëqesh: shishka e lodanumit6; një mikeshë e vjetër dhe e tmerrshme; e si të gjitha mikeshat, mjerisht! bujare në përkëdhelje e tradhtira.

Oh! Koha u shfaq përsëri; Koha mbretëron e plot-fuqishme tashmë; dhe bashkë me plakën e shëmtuar është kthyer e gjithë shpura djallëzore e Kujtimeve, Keqardhjeve, Ngërçeve, Frikërave, Anktheve, Maktheve, Pezmeve dhe Nevrozave.

Ju siguroj që tani sekondat janë bërë të forta e solemne, dhe çdonjëra, duke u sulur jashtë lavjer-rësit, thotë: “Unë jam Jeta, e padurueshmja dhe mi-zorja Jetë!”.

Ekziston vetëm një sekondë në jetën njerëzore që ka për mision të japë një lajm të mirë, lajmin e mirë që i shkakton gjithkujt një frikë të pashpjegueshme.

Po! Koha mbretëron; ajo e vendosi përsëri tiraninë e saj brutale, ndërsa mua më shtyn përpara si ka, me hostenin e saj të dyfishtë. “Hya! Ec pra, go-mar! Djersit pra, skllav! Jeto pra, i mallkuar!”

VI
SECILI KIMERËN E VET

Nën një qiell të gjerë gri, mbi një fushë të gjerë e me pluhur, pa shtigje, pa lëndina, pa një gjembaç, pa një hithër, takova disa njerëz që ecnin të kërru-sur.

Secili prej tyre mbartte mbi shpinë një kimerë7 të madhe, po aq të rëndë sa një thes me miell a me qymyr, apo pajisjet e një ushtari romak.

Por kafsha e përbindshme nuk ishte një peshë pa jetë; përkundrazi, ajo e mbështillte dhe e shtypte njeriun me muskujt e saj të fuqishëm e të zhdërvjellët dhe mbërthehej me ca kthetra të mëdha mbi gjoksin e mbartësit të vet, ndërsa koka e saj e stërmadhe kapërcente ballin e njeriut dhe dukej si një nga ato helmetat e lemerishme, me anë të të cilave luftëtarët e lashtë shpresonin t’ia shtonin tmerrin armikut.

Pyeta njërin prej tyre se ku shkonin ashtu. Ai m’u përgjigj se nuk dinte gjë, as ai, as të tjerët; por me siguri që po shkonin diku, meqenëse një nevojë e pamposhtshme i shtynte që të ecnin.

Diçka e çuditshme më ra në sy: asnjëri prej këtyre udhëtarëve nuk dukej të ishte i acaruar kundër bishës së tmerrshme që i varej qafës e i qepej shpinës; thua se e quante si pjesë përbërëse të vetes. Të gjitha ato fytyra të lodhura e serioze nuk tregonin asnjë lloj dëshpërimi; nën kupolën e zymtë qiellore, me këmbë të zhytura në pluhurin e një toke po aq të pikëlluar sa dhe qielli, ata ecnin me pamjen e nënshtruar të atyre që janë të dënuar të shpresojnë pafundësisht.

Procesioni kaloi pranë meje dhe u zhyt në hori-zont, aty ku sipërfaqja e rrumbullakuar e planetit i përvidhet kureshtjes së vështrimit njerëzor.

Për disa çaste u mundova me ngulm të kuptoja këtë mister; por shumë shpejt e papërballueshmja Mospërfillje më kaploi dhe unë u ndjeva edhe më i dërrmuar sesa ata vetë nën kimerat e tyre shtypëse8.

VII
I ÇMENDURI DHE VENUSI

Ç’ditë e mrekullueshme! Parku i madh prehet nën syrin përvëlues të diellit, sikurse rinia nën sun-dimin e Dashurisë.

Ekstaza e përgjithshme e sendeve nuk shprehet nëpërmjet asnjë zhurme; edhe vetë ujërat janë si të përgjumura. Krejt ndryshe nga festat njerëzore, orgjia këtu është e heshtur...

Duket sikur një dritë, përherë e më e fortë, e bën çdo gjë të vezullojë gjithnjë e më shumë; sikur lulet e harlisura digjen nga dëshira për të rivalizuar me

ngjyrat e tyre të ndezura kaltërsinë e qiellit, ndërsa të nxehtët i bën aromat të dukshme dhe i ngjit drejt yllit flakërues në formë shtëllungash tymi.

E megjithatë, në mes të këtij ngazëllimi të përbotshëm, pikasa një qenie të pikëlluar.

Në këmbë të një Venusi madhështor, një nga ata palaçot9, ata klounët vullnetarë që kanë për detyrë të bëjnë të qeshin mbretërit kur ata i pushton Pen-dimi apo Mërzia, i kullandreprsur me një kostum qesharak gjithë shkëlqim, me brirë e zilka në kokë, i mbledhur kruspull pas piedestalit, ngre sytë me lot drejt Perëndeshës së pavdekshme.

Dhe sytë e tij thonë: “Unë jam më i fundmi dhe më i vetmuari i njerëzve, nuk kam as dashuri as miqësi, dhe ndihem ca më poshtë edhe se kafsha më primitive. Por edhe unë jam krijuar për të kuptuar dhe ndier Bukurinë e pavdekshme! Ah! Perëndeshë! kini mëshirë për trishtimin dhe jermin tim!”.

Por e pamëshirshmja Venus shikon, nuk e di çfarë, diku larg, me sytë e saj të mermertë.

VIII
QENI DHE SHISHJA

“- Qeni im i bukur, qeni im i mirë, konia ime e dashur, afrohu dhe merri erë një parfumi të mrekul-lueshëm që e kam blerë te parfumeria më e mirë e qytetit.”

Dhe qeni, duke tundur bishtin, shenjë që më duket se përkon me buzëqeshjen te këto qenie të mjera, afron me kureshtje hundën e lagësht te shi-shja e hapur; pastaj, duke u sprapsur papritur me tmerr, leh kundër meje, në shenjë qortimi.

“- Ah! qen i poshtër, po të të kisha dhuruar ndonjë copë të pëgëre, do ta kishe nuhatur gjithë ëndje, e ndoshta gllabëruar. Pra, dhe ti, more mik i padenjë i jetës sime të trishtuar, i ngjan publikut, të cilit kurrë s’i duhen dhënë parfume delikate që e acarojnë, por vetëm plehra të zgjedhura me kujdes.”



Bashkim Kuçuku
Jorina Kryeziu (Shkreta)

ENCIKLOPEDI KADAREANE

Vëllimi I

L'ENCYCLOPÉDIE
KADARÉENNE

Volume I

THE KADAREAN
ENCYCLOPEDIA

Volume I

Onufri